

Trajektorja
Gruevski kërkon
xhirim të seancave gjyqësore

Fq.5



REFORMA NË ARSIM
Cilësia nuk varet nga forma, por përmbajtja

Fq.6



Jam duke e kapur formën që më duhet

Asani

Fq.19



Koha

www.koha.mk



Demarkacioni rrezikon Haradinajn

Fq.14

E PËRDITSHME INFORMATIVE

Viti XII · Numri 3239 · e enjte 7 dhjetor 2017

6°C | +11°C

15 DEN

EDITORIAL

Plaga e madhe



Arsim i shqip në Maqedoni ka kohë që ka dalë jashtë binareve të asaj që quhet normale. Ndonëse pritej që vala e demokracisë të sjellë sado pak një avancim në lëmin e arsimit, fatkeqësisht ndodhi e kundërta, arsimit filloi të përjetojë një rrënim... Fq.2

RAJON

Në mes të Gjermanisë pa drita dhe ngrohje

Fq.15

RAJON

Lajmi i rremë krijon "ushtrinë paramilitare" në Bosnjë

Fq.14

GLOBI

Zjarrfikës, filozof, dhe pa diplomë fare

Fq.15



ASH NUK HEQ DORË NGA MINISTRIA QË DREJTONTE TARA VARI

SHËNDETËSIA, PASTAJ RIKONSTRIMUM I QEVERISË



Se më shumë shanse ka që Shëndetësia t'i takojë përsëri ASH-së e thotë për gazetën KOHA edhe njëri nga zyrtarët më të lartë të LSDM-së, por që deshi të mbete anonim. "Shanset serioze janë që Ministria e Shëndetësisë të mbetet e njëjtë, në duar të ASH-së, edhe pse në tavolinë ka dhe opsione tjera". Megjithatë, KOHA merr vesh kjo ministri Selës mund t'i merret pas tre-katër muajve, kur pritet një rikonstruim më i gjerë i kabinetit qeveritar

Fq.3

Gjashtë përvjetorë shqiptarë në kalendarin 2018

Shkup, 6 dhjetor - Komisioni Parlamentar i Kulturës ka miratuar propozimet për shënimin e datave jubilarë për vitin e ardhshëm. Janë gjithsej gjashtë përvjetorë që lidhen me kulturën dhe historinë shqiptare, data dhe personalitetet, që do të bëhen pjesë e kalendarit të shënimeve zyrtare. Përvjetori i 550 vdekjes së Skënderbeut (17 janar në Lezhë), 110 vjetori i Kongresit të Manastirit (14-22 nëntor), 150 vje-

tori i Josif Bagerit, 100 vjetori i lindjes dhe 70 vjetori i vdekjes së Nexhat Agollit, 90 vjetori i lindjes së Murat Isakut dhe 5 vjetori i vdekjes së Abdyrrahman Alitit, janë datat e vetme për pjesën shqiptare që kanë plotësuar të gjitha kërkesat dhe si të tilla janë miratuar në seancën e së mërkurës në Komision. "Gjatë kësaj periudhe arritën një sërë propozimesh, por vetëm këto të gjashta u miratuan, duke plotësuar... Fq.4



EDITORIAL

PLAGA E MADHE

Pa përjashtim, në të gjitha institucionet e arsimit shqip, sot me shumë ka politikë e biznes, se sa arsimim të mirëfilltë



Shkëlzen HALIMI

Arsim i shqip në Maqedoni ka kohë që ka dalë jashtë binareve të asaj që quhet normale. Ndonëse pritej që vala e demokracisë të sjellë sado pak një avancim në lëmin e arsimit, fatkeqësisht ndodhi e kundërta, arsimit filloi të përjetojë një rrënim të tmerrshëm. Më shumë se 20 vjet, institucionet tona prodhojnë gjysmanalfabetë, për të mos thënë analfabetë, kurse shoqëria shqiptare asnjëherë kësaj çështje nuk iu është qasur ashtu siç duhet. Dhe, çfarë mund të pritët kur gjitha "frenat" e arsimit i mban politika, e cila është bërë makineria e tmerrshme e rekrutimit të kuadrove, pjesa dërmuese e të cilëve, "potencialin" intelektual e dëshmojnë me diploma të dyshimta.

Pa përjashtim, në të gjitha institucionet e arsimit shqip, sot me shumë ka politikë e biznes, se sa arsimim të mirëfilltë. Ndërkaq, rezultatet e kësaj fatkeqësie tashmë po reflektohen në të gjitha aspektet që e bëjnë një shoqëri të shëndoshë. Është numri i madh i atyre që shkollat i shfrytëzojnë thjeshtë për ta marrë pagën mujore, pavarësisht që nuk ndjejnë asfale përgjegjësie për dëmtimin e gjeneratave të reja, të cilat, në të ardhmen, do të jenë të hendikepuara përballë shumë sfidave në jetën e tyre. Jo një herë në kaluarën kemi thënë se është koha që të ndërrimet diçka që t'i jepet fund shkatërrimit të indit më të rëndësishëm të çdo populli, arsimit. Por, ja që ajo kohë assesi të vijë.

Hapi i parë dhe më i shëndoshë është që të gjithë ata që në shkollat tona janë punësuar me ndërmjetësime partiake, të kthehen në klasë të parë dhe, pastaj, hap pas hapi, gjithnjë duke e nxehur karrigen, të kryejnë me nder shkollën. Kjo jo vetëm që do të ishte e shëndetshme për ta, por edhe për tërë shoqërinë tonë, që konsum të përditshëm, ditë e natë, edhe kur kotet, ka politikën, e cila e kundrohët vetëm si një trampolinë për të arritur me një HOP atje, ku në fakt, arrihet me shumë mudi, djersë e përpjekje.

Nuk jemi të vetëdijshëm se çfarë dëmi i kemi bërë vetvetes, nuk jemi të vetëdijshëm se sa kohë që kemi humbur dhe sa do të humbim nëse vendosim ta shërojmë këtë plagë të madhe, e cila shpesh duket e pashërueshme. Xixat e para të optimizimit mund të na vijnë vetëm nëse nga arsimit fillon të largohet politika dhe nëse i hapet shtegu vetëdijes se është e domosdoshme, mbase jetike, kthimi në binaret e funksionimit normal të arsimit shqip.

Ndryshe, plaga e madhe shumë shpejtë mund t'i paraqesë simptomat e para të kancerit në arsimit shqip. Pastaj, pastaj as djalli më s'na vjen në ndihmë...

KUR KOSOVA BLOKOHET NGA KS

"Sot 100 vjet, Finlanda u pavarësua nga pushtimi Rus. Ndonëse në kufi me Rusinë, kundër së cilës kishte luftuar dy here dhe me konteste territoriale; ajo është anëtare e OKB. Kosova tash dhjetë vite shpalli pavarësimin - jo nga Rusia, kundër së cilës nuk luftoi asnjëherë, as ndanë kufij e as territor; por ende bllokohet nga vetoja e saj, në Këshillin e Sigurimit", shkruan në FB profesori Blerim Reka.



NËSE KE...

"Nëse ke ushqim në frigorifer, rroba në çantë, kulm mbi kokë dhe një vend për të fjetur - je më i pasur se 75% e njerëzve të botës. Nëse ke para në bankë, në kuletë dhe ca para rezervë - je në mesin e 8% e më të pasurve të botës. Nëse nuk ke përjetuar asnjëherë rrezikun e betejës, vuajtjet e burgut apo torturës ose ndjesinë e urisë - je më fatlum se 500 milion njerëz të gjallë në vuajtje. Nëse je zgjuar këtë mëngjes me më shumë shëndet se sëmundje - je më i bekuar se miliona njerëz që nuk do të mbijetojnë këtë javë. Nëse mund ta lexosh këtë informacion - je më fatlum se 3 miliard njerëz që nuk dijnë të lexojnë aspak", shkruan psikologu Muhamed Jonuzi në FB.



MENTALITETI I ODËS SË BURRAVE

"Para tri javësh zgafellen e kisha titulluar "Mentaliteti i Odës së Burrave". Sonte e pamë në xhirim se çka nënkupton ky mentalitet. Veç burra të mbledhur në odë; sharki e çifteli me tekste që "grinë e copëtojnë armikun"; tym duhani deri në dysheme; qitje kot së koti me armë... E këta janë zyrtarë shtetërorë. Këta e shohin shtetin si Odë të Burrave edhe ashtu e kontrollojnë atë, me rregullat e Odës. Mirësevini në shekujt e mesëm!", shkruan Flaka Surroi me rastin e "festës" në Drenas të lirimit të Fatmir Limajt nga akuzat e Prokurorisë speciale të Kosovës.



KSHZ TEST SERIOZ PËR PUSHTETIN

"Pushteti testohet në zgjedhje, KSHZ test serioz për pushtetin", shkruan në profilin e tij në Facebook, gazetari Sefer Tahiri, duke komentuar skandalin për ndarjen e bonuseve në mijëra euro nga anëtarët e Komisionit Shtetëror Zgjedhor.



NË VORBULLËN E SITUATAVE...

"Në vorbullën e përsëritjeve të intrigave politike. Në vorbullën e situatave të pafundme që prodhojnë komiken dhe një sfond i trishtë arratish që vjen si pasojë e groteskut të quajtur pushtet. Një tekst që i sjellë këto paradokse dhe që demaskon prapaskenat përmes komikes. Një lojë skenike që transmetoi komunikim me publikun. Komedia 'Vorbulla' solli energji krijuese dhe komunikoi ngrohtë me publikun", shkruan publicisti Bardhyl Zaimi në profilin e tij në Facebook.



MEDIACitate

Ambasadorja e Finlandës në Kosovë, Anne Huhtamwki, gjatë një interviste ekskluzive për gazetën "Zëri" ka deklaruar se Kosova dhe Bashkimi Evropian kanë rënë dakord për kushtet që duhen plotësuar për liberalizimin e vizave. Sipas saj, për të ndodhur liberalizimi është në dorën e Kosovës që t'i përmbushë dy kushtet e mbetura, demarkacionin me Malin e Zi, si dhe të dhënat e evidentuara kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit. Kosova dhe Bashkimi Evropian (BE) kanë rënë dakord për kushtet që duhen plotësuar për liberalizimin e vizave. Kanë mbetur vetëm edhe dy kritere të paplotësuar: Marrëveshja e Demarkacionit me Malin e Zi, si dhe të dhënat e evidentuara kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit.

(Zëri, 6 dhjetor)

Shqipëria mund të hapë negociatat e anëtarësimit me Bashkimin Evropian pranverën e ardhshme. Në vizitën e tij dy ditore në Bruksel kreu i qeverisë shqiptare Edi Rama ka arritur të marrë vlerësimin e krerëve të institucioneve më të larta të BE për reformat e qeverisë së tij, dhe mbi të gjitha reformës në drejtësi. Presidenti i Komisionit Evropian Jean-Claude Juncker tha në konferencën për shtyp se nëse ecuria e reformave do të jetë e njëjta edhe në 6 muajt e ardhshëm ai do t'i rekomandojë komisionit çeljen e negociatave.

(TV Klan, 6 dhjetor)

Qeveria e Gjermanisë në sfodin e planeve të presidentit të SHBA-së Donald Trump për njohjen e Jerusalemit si kryeqytet të Izraelit tërheq vëmendjen për rrezikun e trazirave në këtë qytet si dhe në Jordanin Perëndimor e në Gazë. Duke nisur nga kjo e mërkurë (06.11) në këto territore mund të ketë demonstrata, thuhet në udhëzuesin e aktualizuar të Ministrisë së Jashtme gjermane për ata që udhëtojnë drejt këtyre vendeve. "Trazirat e dhunshme nuk mund të përjashtohen". Ministri i Jashtëm britanik Boris Johnson, në kuadër të një takimi të NATO-s në Bruksel, tha se qeveria e tij i sheh me "shqetësim" këto zhvillime. Londra është e mendimit, se statusi i Jerusalemit duhet të jetë pjesë e një zgjidhjeje përmes bisedimeve mes Izraelit dhe Palestinezëve.

(DW, 6 dhjetor)

NËSE NUK
E KENI DITUR...

KOMITETI I JANINËS

Komiteti i Janinës ishte organ kombëtar shqiptar me qendër në Janinë, i formuar në maj të vitit 1877, nën kryesinë e Abdyl Frashërit. Komiteti i paraqiti një memorandum qeverisë së Stambollit, më anë të së cilit i tërhiqte vëmendjen Portës së Lartë, mbi gjendjen e keqe në të cilën ndodheshin krahinat shqiptare dhe shtronte kërkesën për bashkimin e të gjitha krahinave të banuara prej shqiptarëve në një vilajet të vetëm. Komiteti i

Janinës u orvat të lidhte një aleancë ushtarake me qeverinë greke, në bazë të së cilës pala shqiptare përkrahte shtetin grek, që të shtrihej në tokat e Tesalisë, Maqedonisë dhe Trakës, ndërsa qeveria e Athinës do të mbështeste formimin e principatës së pavarur shqiptare. Qeveria greke nuk e përkrahu idenë e principatës së pavarur shqiptare dhe nuk hoqi dorë nga synimet e saj pushtuese në Shqipërinë e Jugut.



„Shqiptarët kanë një vullnet të patundur që të mbrojnë atdheun e tyre deri në fund dhe janë betuar të mos lëshojnë asnjë pëllëmbë tokë por të vdesin për të po të jetë nevoja. Këtu manifestojmë mendimin e të gjithë bashkë-atdhetarëve tanë.“

Abdyl Frashëri

ASH NUK HEQ DORË NGA MINISTRIA QË DREJTONTE TARA VARI

SHËNDETËSIA, PASTAJ RIKONSTRUIUM I QEVERISË

Se më shumë shanse ka që Shëndetësia t'i takojë përsëri ASH-së e thotë për gazetën KOHA edhe njëri nga zyrtarët më të lartë të LSDM-së, por që deshi të mbete anonim. "Shanset serioze janë që Ministria e Shëndetësisë të mbetet e njëjtë, në duar të ASH-së, edhe pse në tavolinë ka dhe opsione tjera". Megjithatë, KOHA merr vesh kjo ministri Selës mund t'i merret pas tre-katër muajve, kur pritet një rikonstruim më i gjerë i kabinetit qeveritar

Koha

Fatos RUSHITI

Shkup, 7 dhjetor - Kompletimi i kabinetit qeveritar me emërimin e ministrit të Shëndetësisë, ministrit pa resor që mbulon Investimet e huaja dhe zëvendësministrit të Arsimit, po vonon edhe më tej. Shtizat vazhdojnë të thyhen tek Ministria e Shëndetësisë, ministri kjo që kërkohet nga LSDM-së e që më parë udhëhiqej nga kuadër i Aleancës për Shqiptarët. Por siç merr vesh gazeta KOHA në rrugë jozyrtare, Shëndetësia prej tre deri në pesë muaj do ti takojë ASH-së deri në një rikonstruim të gjerë të Qeverisë. Se më shumë shanse ka që Shëndetësia t'i takojë përsëri ASH-së e thotë për gazetën KOHA edhe njëri nga zyrtarët më të lartë të LSDM-së, por që deshi të mbete anonim. "Shanset serioze janë që Ministria e Shëndetësisë të mbetet e njëjtë, në duar të ASH-së, edhe pse në tavolinë ka dhe opsione tjera", tha për gazetën njëri nga zyrtarët e lartë të LSDM-së. Për rekonstruim pak më të gjerë të Qeverisë gazeta KOHA raportoi edhe tre javë më parë, ku do të lëviznin tre deri në katër dikastere mes partnerëve qeveritar - Shëndetësia, Arsimit, Drejtësia dhe Transporti. Nga ASH bëjnë të ditur se në takimin e fundit që kanë pasur liderët Zoran Zaev dhe Ziadin Sela, edhe atë para dhjetë ditësh, nuk është përmendur posti i "zëvendëskryeministrit për reforma" si kompensim për ASH që kjo të dorëzojë dikasterin e Shëndetësisë. Sipas asaj që thonë nga ASH, informatat janë plasuar nga individë dhe media të afërta me LSDM-në, por që kjo nuk do të ndodh për asnjë arsye. I vetmi kompromis që mund të bëjë ASH është që të drejtojë ndonjë ministri tjetër të rëndësishme si ajo e Arsimit apo e Transportit dhe Lidhjeve, thonë nga ASH. "Parimisht, ASH është e vendosur të qëndrojë në Qeveri edhe përkundër obstrukcioneve të rivalëve tanë politik. E dyta, ASH do të bëjë kompromis vetëm nëse sigurohet se ajo do të

udhëheq me post ministri me peshë të njëjtë me Ministrinë e Shëndetësisë, por jo post zëvendëskryeministri. Siç e dimë ne, Zaevi nuk i ka përmendur Ziadin Selës në takimin e fundit postin e 'zëvendëskryeministrit për reforma'. Informatat kanë dale nga individë që kanë punuar gjithmonë për interes të maqedonasve duke dëmtuar peshën politike të partive shqiptare, si dhe nga media të caktuara. Ne nuk mund të prejdukim se çdo të ndodh deri në fund për këtë çështje, por habitemi se si një kryeministër që flet për reforma, e vonon pikërisht kompletimin e Qeverisë. Nëse e ka presione nga BDI që ASH të mos udhëheq me Shëndetësinë, siç po flitet - duhet ta ketë gabim, sepse ishte ASH që i mundësoi marrjen e mandatit për formimin e Qeverisë, ngase dikush tjetër deri në moment të fundit kalkulonte me VMRO-në. Urojmë të mos e harrojmë këtë Zaevi. Tjetra, Zaevi duhet të dijë se nga pozicionin e ASH-së në Qeveri e determinojnë votat që mori në zgjedhje lokale dhe çdo kalkulim tjetër, Zaevi e di që nuk do pritej mirë nga ambasadat e rëndësishme në vendin tonë", thonë zyrtarë të lartë të ASH-së. Nga ana tjetër, thonë në ASH, nëse LSDM do të insistojë në postin e "zëvendëskryeministrit për reforma", kjo parti mund të kërcënojë me braktisje të Qeverisë si e vetmja mënyrë për të mbajtur post të rëndësishëm sikurse është ministria.

Ndryshe, nga deklarata për media e kryeministrit Zaev që dha më 3 dhjetor, duket qartë që kjo parti synon të marrë Shëndetësinë. "Po bisedohet për plotësimin e vendit të ministrit të Shëndetësisë pas largimit të kryetarit të Costivarit, doktor Arben

Taravari. Kjo pasi që gjatë ndarjes fillestare të resorëve, Shëndetësia iu dha Aleancës për shkak të doktor Taravarit, i cili ishte i pranueshëm për mjekët gjithandej Maqedonisë. Tani flasim vetëm për atë se si ta plotësojmë këtë vend. Nuk po bëjmë kombinime të reja. Edhe disa ditë do të publikojmë kornizën e plotë të Qeverisë", u shpreh Zaevi tre ditë më parë. Zaevi, përveç takimit që ka pasur me kryetarin ASH-së, Ziadin Sela, një takim ka pasur edhe me kryetarin BDI-së,



Zaevi, përveç takimit që ka pasur me kryetarin ASH-së, Ziadin Sela, një takim ka pasur edhe me kryetarin BDI-së, Ali Ahmeti, por pa dhënë asnjë detaj për publikun. Nga BDI përjashtojnë zërat se i bëjnë presion Zaevit që ASH të mos e mbajë Shëndetësinë

Ali Ahmeti, por pa dhënë asnjë detaj për publikun. Nga BDI përjashtojnë zërat se i bëjnë presion Zaevit që ASH të mos e mbajë Shëndetësinë, por sipas disa burimeve të afërta me këtë parti, merret vesh se LSDM me këto lëvizje dëshiron të bind shqiptarët se mënyra më e mirë është që ata të anëtarësohen në LSDM e jo të vrapojnë pas partive tjera shqiptare. "Në LSDM ka një grup që më shumë interesohen që kjo parti të anëtarësojë shqiptarë dhe me kalkulimet për Shëndetësinë, e ka vetëm që të bind shqiptarët se LSDM është shpresa për ata e jo dhe partitë tjera shqiptare. BDI ka pozicionet e veta dhe ka kuadro të përgatitur që në çdo kohë të plotësojnë vendet e zbrazura dhe nuk harxhojmë energji kundër asnjë partie politike shqiptare", thonë burime të afërta me BDI-në. Gazeta KOHA u përpoq të marrë deklaratë edhe nga nënkryetari i LSDM-së, Damjan Mançevski, dhe sekretari i përgjithshëm, Aleksandër Kiracovski. Ky i fundit, edhe pas premtimeve se do të qartësojë pozicionin partiak për Ministrinë e Shëndetësisë, deri në mbylljen e gazetës nuk dha përgjigje.

Ballkani t'i qetësojë tensionet

Bruksel, 6 dhjetor - Apelojmë deri tetë gjitha palët në Ballkanin Perëndimor të bëjnë çmos për zvogëlimin e tensioneve, shmangien e retorikës nxitëse dhe pengimin e përlëshjeve të reja të armatosura në rajon, deklaroi sekretari i përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg. "Përgjegjësia kryesore para së gjithash është e vendeve në rajon, por edhe e NATO-s, që të ndihmojë në shmangien e përlëshjeve eventuale në Ballkanin Perëndimor", deklaroi sekretari i përgjithshëm i NATO-s, duke komentuar gjendjen aktuale të sigurisë në rajon. Stoltenberg theksoi se NATO-ja luan rol të rëndësishëm në Ballkan me dekada, se Aleanca ka kontribuar për përfundimin e dy luftërave etnike, si dhe se angazhimi i saj i parë i madh jashtë territorit të saj ka qenë pikërisht në Ballkan - Në Bosnjë e Hercegovinë, e pastaj në Kosovë.

"Ende kemi prani të konsiderueshme në Ballkan, këtu është misioni i ynë KFOR në Kosovë", tha ai, duke shtuar se Aleanca është e pranishme edhe në Shkup edhe në Sarajevë, si edhe në vendet nga rajoni, të cilat tani janë anëtare të NATO-s - Sllovenia, Kroacia dhe Mali i Zi. Stoltenberg potencoi se NATO bashkëpunon me të gjithë partnerët nga rajoni.

Thaçi takoi zyrtarët e Ambasadës Amerikane

Tetovë, 6 dhjetor - Kryetari i Partisë Demokratike Shqiptare (PDSH), Menduh Thaçi të mërkurën në selinë e partisë priti në takim zyrtarët për çështje politike pranë Ambasadës së SHBA-së në vend, Paul Gradon dhe Diva Hakins. Në takim u bisedua për zhvillimet e fundit në vend, si dhe për ecurinë e reformave që Maqedonia duhet ti përmbush drejt proceseve integruese. "Kryetari Thaçi theksoi urgjencën e zgjidhjes së kontestit të emrit me që do të mundësonte anëtarësimin e Maqedonisë në NATO, duke potencuar se procesi Euro-Atlantik është prioritet absolut për Partinë Demokratike Shqiptare dhe shqiptarët e Maqedonisë. Kryetari Thaçi gjithashtu potencoi se Partia Demokratike Shqiptare do të jetë konstruktive dhe do të përkrah çdo nismë institucionale që ka të bëjë me avancimin e të drejtave të shqiptarëve, me reformat e mirëfillta si dhe me deblokimin e proceseve integruese. Bashkëbiseduesit u pajtuan që duhet të jepet kontribut maksimal për integrimin e vendit në strukturat euro-atlantike, dhe se në këtë drejtim rikthimi i dialogut të mirëfilltë politik është me rëndësi të veçantë, ku të gjitha palët duhet të mbajnë pjesën e tyre të përgjegjësisë dhe të ndihmojnë lëvizjen e proceseve përpara drejt integritimit në NATO dhe BE", thuhet në komunikatën e PDSH-së.

KOMISIONI I KULTURËS MIRATON DATAT

GJASHTË PËRVJETORË SHQIPTARË NË KALENDARIN 2018

Koha

Evis HALILI

Shkup, 6 dhjetor - Komisioni Parlamentar i Kulturës ka miratuar propozimet për shënimin e datave jubilarë për vitin e ardhshëm. Janë gjithsej gjashtë përvjetorë që lidhen me kulturën dhe historinë shqiptare, data dhe personalitete, që do të bëhen pjesë e kalendarit të shënimeve zyrtare. Përvjetori i 550 vdekjes së Skënderbeut (17 janar në Lezhë), 110 vjetori i Kongresit të Manastirit (14-22 nëntor), 150 vjetori i Josif Bagerit, 100 vjetori i lindjes dhe 70 vjetori i vdekjes së Nexhat Agollit, 90 vjetori i lindjes së Murat Isakut dhe 5 vjetori i vdekjes së Abdyrrahman Alitit, janë datat e vetme për pjesën shqiptare që kanë plotësuar të gjitha kërkesat dhe si të tilla janë miratuar në seancën e së mërkurës në Komision.

"Gjatë kësaj periudhe arritën një sërë propozimesh, por vetëm këto të gjashta u miratuan, duke plotësuar të gjitha specifikat dhe

kushtet që duhet të korrespondojnë me datat jubilarë. Data e parë që do të shënohet për vitin e ardhshëm ka një ko incidencë edhe me atë që shënohet nga shteti shqiptar, 550 vjetori i vdekjes së heroit tonë kombëtar, Gjergj Kastrioti Skënderbeu", thotë zëvendëskryetari i Komisionit të Kulturës, Rexhail Ismaili, deputet i Bashkimit Demokratik për Integrim. Këto data janë propozuar kryesisht nga institucione, si Instituti i Trashëgimisë, komuna, Shoqata e Historianëve, e të tjera dhe do të shënohen në bashkëpunim mes tyre. Disa propozime të tjera, si 135 vjetori i lindjes së Hasan Prishtinës, 50 vjetori i demonstratave në Prishtinë e Tetovë, nuk janë miratuar. Për shkak të jubileut që nuk korrespondon me kriteret, datat që i takojnë këtij shekulli duhet të mbarojnë me 5, të shekullit të kaluar me 10, të shekullit të 19-të me

25 e me radhë. Komisioni i kulturës ka shqyrtuar rreth 300 propozimeve, pas ftesave që i janë drejtuar 127 institucioneve shtetërore, publike, lokale, shkencore e të tjera, 80 komunave dhe Qytetit të Shkupit.

Këtë vit, dy prej datave të kalendarit do të shënohen edhe në Shqipëri e Kosovë, si përvjetori i ndarjes nga jeta të heroit kombëtar Gjergj Kastrioti, 110 vjetori i Kongresit të Manastirit dhe përcaktimi i alfabetit të njësuar të gjuhës shqipe. Për pjesën maqedonase si data më të rëndësishme, janë 150 vjetori i lindjes së revolucionarit Eftim Sprostanov, përvjetori i Luftës së parë botërore, e të tjera. Kryetarja e Komisionit Irena Stefovaska ka bërë me dije se Programi për bëhet nga gjithsej 62 data që do të shënohen gjatë 2018, pas miratimit edhe nga Parlamenti. Po ashtu Komisioni i Kulturës gjatë kësaj seance ka ngritur edhe një grup pune, i cili do të angazhohet për të vëzhguar nga afër

Janë gjithsej gjashtë përvjetorë që lidhen me kulturën dhe historinë shqiptare që do të bëhen pjesë e kalendarit të shënimeve zyrtare. Përvjetori i 550 vdekjes së Skënderbeut, 110 vjetori i Kongresit të Manastirit, 150 vjetori i Josif Bagerit, 100 vjetori i lindjes dhe 70 vjetori i vdekjes së Nexhat Agollit, 90 vjetori i lindjes së Murat Isakut dhe 5 vjetori i vdekjes së Abdyrrahman Alitit

gjendjen e institucioneve të kulturës dhe sfidat me të cilat përballen. Në këtë grup që do të jetë aktiv vitin e ardhshëm bëjnë pjesë katër deputetë, mes të cilëve edhe Mirsada Emini Asani. Grupi i punës krijohet edhe pas alarmit të vënë nga Ministria e Kulturës për gjendjen e keqe në të cilën ndodhen shumë institucione të kulturës, si muze, teatro, e të tjera.

Dardhishta zgjidhet prokuror në PPRM

Shkup, 6 dhjetor - Këshilli i prokurorëve publikë në seancën e së mërkurës zgjodhi ish-gjykatësin kushtetues dhe ministër të Drejtësisë Ismail Dardhishta për prokuror në Prokurorinë Publike të Republikës së Maqedonisë. Për njeri të parë të Prokurorisë së Lartë në Manastir është emëruar Meri Trombeva, ndërsa Biljana Stefçeva është shefe e Prokurorisë Themelore Publike të Radovishit, ndërsa Hanefi Amet nga Prokuroria e Lartë e Shkupit është zgjedhur për prokuror në Prokurorinë Themelore Publike në Tetovë. Në seancën e sotme të Këshillit janë zgjidhur edhe disa u.d. shefa të prokurorive, të cilët do të jenë ushtrues të detyrës në një ose dy muajt e ardhshëm. Kjo, siç shpjegoi kryetari i Këshillit të prokurorëve publikë Kole Shterjov, njëzëri është dakorduar që prokurori i ri publik Lubomir Jovevski, të mund të formojë ekip personal. Për ushtrues të detyrës të Prokurorisë Publike për ndjekje të krimin të organizuar është emëruar Gordana Smaqoska, në Prokurorinë Themelore Publike-Shkup është emëruar Sasho Rajev, në PTHP Kumanovë është zgjedhur Teuta Bediu, në Kostivar Bashkim Isini, ndërsa njeri i parë në Prokurorinë Themelore Publike të Manastirit mbetet Antonio Jolevski. Për vendet e tjera për të cilat u publikua shpallje, aji do të shfuqizohet dhe do të publikohet shpallje e re.

ZAEVI TAKOI KRYETARIN E PARLAMENTIT EVROPIAN

Reformat po japin rezultate

Shkup, 6 dhjetor - Kryeministri Zoran Zaev, në takimin e së mërkurës në Bruksel me kryetarin e Parlamentit Evropian, Antonio Tajani e shprehu kënaqësinë prej mbështetjes së vazhdueshme për Republikën e Maqedonisë dhe për politikën e zgjerimit që e përfaqëson shumica në Parlamentin Evropian, që vazhdimisht demonstron përmes raporteve të ndryshme, deklaratave edhe aktivitetëve nga europarlamentarët dhe grupet politike. "Parlamenti Evropian ishte institucioni i parë i BE-së i cili veproi dhe ofroi shërbime për ndërmjetësim kur në Maqedoni u paraqit kriza politike dhe vazhdon të jetë një prej partnerëve më të sigurt në Qeverinë e Republikës së Maqedonisë, në interes të vendit", tha kryeministri Zaev, duke shtuar se në këtë drejtim pret që të pritët edhe nisma më e re

e njërit prej deputetëve evropian, e a.q. iniciativa e Zhan Monesë. Siç kumtoi pres shërbimi qeveritar, Zaev e njoftoi Tajani me qëllimin kryesor të Qeverisë - të bëhet gjithçka që viti 2018 të jetë vit i suksesit për Maqedoninë, me sjelljen e vendimit për fillimin e negociatave për inkuadrim. "Qasja jonë në politikë, edhe në atë vendore edhe në atë ndërkombëtare, vepron pa agjenda të fshehta dhe sinqerisht i zgjidh të gjitha çështjet, pa dallim se sa janë të lehta apo të rënda ato. Na vjen mirë që ambicia jonë dhe gatishmëria për hapa të vërtetë në procesin e inkuadrimin në BE përputhen me impulsin e rinovuar dhe interesin e zgjerimit në BE", theksoi kryeministri Zaev në takimin me kryetarin e Parlamentit Evropian. Në takim kryeministri Zaev theksoi se "tani është koha që të shfrytë-

zohen këto angazhime dhe në gjysmën e parë të vitit 2018, Këshilli i BE-së të miratojë vendim për fillimin e negociatave inkuadruese, për të cilën pritët të arrijë nga Komisioni Evropian". Nga Qeveria e RM-së, theksoi Zaev, ekziston përkushtim i qartë dhe i pakontestuëshëm dhe energji që të tregohen rezultate. "Dërgimi i rezultateve të vërteta prej reformave si argument i yni, janë bileta jonë, pa të cilën nuk mund të kërkojmë e të presim vendim për fillimin e negociatave për inkuadrim. Jemi duke bërë përpjekje për vendosjen e serishme të Maqedonisë si partner kredibil i miqve të vet ndërkombëtar", theksoi kryeministri Zaev në këtë takim. Kryetari i PE-së, Tajani shprehu urime për procesin reformues që e hapi Republika e Maqedonisë dhe veçanërisht që, theksohet, ai tashmë jep rezul-



tate të dukshme. Në emrin e tij dhe në emër të PE-së Tajani shprehu pritje se në strategjinë e re për zgjerimin e BE-së, që pritët të publikohet së shpejti, do të dërgohet mesazh i qartë se Republika e Maqedonisë dhe vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor janë në prioritetet e kësaj strategjie. "Kryetari i PE-së, Antonio Tajani e shprehu mbështetjen e hapur të këtij institucioni për Republikën e Maqedonisë, paralajmëroi intensifikimin e bashkëpunimit me Kuvendin e RM-

së, si dhe mbështetjen në motivimin e investitorëve të BE-së t'i kushtojnë vëmendje mundësive për biznes në Republikën e Maqedonisë", thuhet në kumtesë. Në takimin, e kryeministrit Zaev me njeriun e parë të PE-së Tajani, i cili u realizua menjëherë pas Mëngjesit të lutjeve në Parlamentin Evropian, morën pjesë edhe anëtarët e delegacionit qeveritar, zëvendëskryeministri për Çështje Evropiane, Bujar Osmani dhe Nikola Dimitrov, ministër i Punëve të Jashtme.

“TRAJEKTORJA” ANULOHEP PËR MË 18 DHJETOR

GRUEVSKI KËRKON XHIRIM AUDIO-VIZUAL TË SEANCAVE GJYQËSORE

Koha


Omer XHAFFERI

Shkup, 6 nëntor - Gjykimi i radhës kundër ish kryeministrit Nikolla Gruevski, për rastin “Trajektorja”, i iniciuar nga Prokuroria Speciale Publike, të mërkurën u anulua për datë 18 dhjetor. Mungesa e pajisjeve teknike për mbulimin e seancës gjyqësore, ishte arsyeja kryesore se pse Këshilli penal, i kryesuar nga gjykatësi Goran Boshevski, vendosi ta pranojë kërkesën e avokatëve në këtë lëndë. Në emër të palës mbrojtëse, avokati Elenko Millano, para fillimit të seancës gjyqësore kundër ish funksionarëve të lartë të pushtetit të kaluar, tha se kërkojnë që ky proces gjyqësor, krahas procesverbalit, të regjistrohet edhe me pamje vizuale dhe audio xhirim.

Me qëllim mënjanimin e lëshimeve që bëhen gjatë përgatitjes së procesverbale, në Ligjin për procedure penale, i cili është në fuqi prej vitit 2013, qëndron se seancat kryesore gjyqësore të xhirohen në formë audio ose video-vizuale. Mirëpo, nga prezencat e mediave dhe opinionit në seanca gjyqësore, mund të thuhet se kjo mënyrë e procedimit të seancave gjyqësore, zbatohet pjesërisht. Këto lëshime, përmes një raporti i prezantoi edhe Komiteti i Helsinkit, sipas të cilit procesverbalet në procedura penale edhe më tej përpilohen nën diktimin dhe dirigjimin e gjykatësve. Nikolla Gruevski, pas prolongimit të seancës gjyqësore për rastin “Trajektorja”, tha se ai dhe bashkëpunëtorët e tij akuzohen për një çështje të cilën në të kaluarën e ka bërë edhe Qeveria e LSDM-së.

“Ne kishim rast kur Qeveria e LSDM-së, gjatë ndërtimit të Hidrocentralit të Kozjakut mori kredi nga Kina dhe kështu e përfundoi. Dhe ne sot akuzohemi për një veprim, të cilin, po ashtu, ata e kanë bërë. Gjithçka kemi bërë është në pajtim me ligjin dhe Parlamenti në këtë procedurë kishte qasje. Ndërsa, sa i përket ndërtimit të autostradës Kërçovë-Ohër, ajo u fillua edhe me votat e LSDM-së”, tha i akuzuari, Gruevski.

Nikolla Gruevski, pas prolongimit të seancës gjyqësore për rastin “Trajektorja”, tha se ai dhe bashkëpunëtorët e tij akuzohen për një çështje të cilën në të kaluarën e ka bërë edhe Qeveria e LSDM-së



“THESARI” PRANOHEP NGA GJPSH-JA

Këshilli për vlerësimin e aktakuzës pranë Gjykatës Penale të Shkupit, të mërkurën e ka miratuar aktakuzën e Prokurorisë Speciale Publike (PSP) për rastin “Thesari”, ku të akuzuar janë ish-Drejtori për Siguri dhe Kundërzbulim (DSK), Sasho Mijallkov, ish-shefi i Drejtorisë së Pestë, Goran Grujovski, i cili pritet të ekstradohet nga Selaniku, ish-shefi i Kabinetit të

Përveç ish kryeministrit, në lëndën gjyqësore “Trajektorja” si të dyshuar akuzohen Vladimir Peshevski, Mile Janakievski dhe Lupço Georgievski. Të gjithë të akuzuarit, së bashku me përfaqësuesit e tyre ligjorë, të mërkurë u paraqitën në Gjykatën Penale të Shkupit. Aktakuza e ngritur nga PSP-ja për këtë rast, ka të bëjë me kryerje e dy veprave penale, me çka Nikolla Gruevski dyshohet për “Pranim të dhuratës për ndikim të kundërligjshëm”, gjegjësisht tre të akuzuarit tjerë akuzohen për veprën penale “keqpërdorim të pozitës dhe detyrës zyrtare”. Veprimet kriminale, sipas PSP-së, të ish zëvendëskryeministrit, Peshevski, ish ministrit të Transportit dhe Lidhjeve, Janakievski dhe ish drejtorit të Ndërmarrjes Publike për Rrugët Shtetërore, Georgievski, i kanë realizuar në pjesën e dytë të vitit 2012 dhe gjatë vitit 2013, gjatë procedurës për ndërtimin e autostradës Shkup-Shtip dhe Kërçovë-Ohër. Thënë ndryshe, kjo treshe e ish funksionarëve akuzohet për keqpërdorim të mjeteve buxhetore, të cilat arrijnë shumë e mbi 155 milionë eurove. Hetimet për rastin “Trajektorja”, PSP-ja i ka filluar në bazë të “bombës” të vitit 2014, të cilën LSDM-ja në vitin 2015 të publikoi, gjegjësisht në këto biseda dëgjohet Nikolla Gruevski dhe Mile Janakievski, se si flasin për përqindjen që duhet të marrin nga kinezët.

Mijallkovit, Toni Jakimovski dhe ish-ndihmësministri i Punëve të Brendshme, Nebojsa Sajkoviç. Aktakuza e iniciuar nga PSP-ja në qershor të këtij viti, këta persona i ngarkon se i kanë shfrytëzuar paratë e shtetit për furnizim me softver nga jashtë gjoja se për nevojat e Drejtorisë së Pestë. Gjykimi për këtë lëndë akoma nuk është caktuar.

Seriali “Maqedonia” në duart e Prokurorisë

Shkup, 6 dhjetor - Prokuroria Themelore Publike për ndjekje të krimit të organizuar dhe korrupsion do të veprojë sipas kallëzimit penal në lidhje me incizimin e serialit artistik “Maqedonia”. Personi i dyshuar nga Agjencia për film e ka dëmtuar Buxhetin e Republikës së Maqedonisë për vlerë prej 68.000.000 denarësh. “Drejtorja e Policisë Financiare në PTHP për ndjekje të krimit të organizuar dhe korrupsionit sot ka parashtruar kallëzim penal kundër një personi për të cilin ekziston dyshim bazë se ka bërë vepër penale Keqpërdorim të pozitës zyrtare dhe autorizim

nga neni 353 paragrafi 5 në lidhje me paragrafin 1 nga Kodi penal”, kumtojnë nga Prokuroria. Personi si subjekt udhëheqës i Agjencisë për film, siç thonë nga Prokuroria, në periudhën nga tetori i vitit 2016 deri në shtator të këtij viti, duke e shfrytëzuar pozitën e tij zyrtare dhe duke i tejkuluar kufijtë e autorizimit të tij zyrtar e ka dëmtuar Buxhetin e RM-së për një vlerë prej 68.000.000 denarësh. “Njëherit, gjatë procedurës për financim të Projektit - seriali artistik ‘Maqedonia’, personi i dyshuar ka mundësuar që Shoqëria për produksion dhe video filmik ‘Jadran

Film’ SHPKNJP Shkup të përfitojë doli pronësore të kundërligjshme në vlerën e lartpërmendur, ndërsa në dëm të Buxhetit të Republikës së Maqedonisë”, theksohet në kumtesë. Për këtë rast, PTHP-ja për ndjekje të krimit të organizuar dhe korrupsionit, siç veç më është publikuar, pas njoftimit nga Drejtoria e Policisë Financiare, muajin e kaluar ka hapur procedurë parahetimore, kallëzimi i sotëm penal është marrë në punë dhe për të po veprohet. Nga Prokuroria thonë se për vijimin e hetimit të hetimit, opinioni në vazhdimësi do të njoftohet.

KRONIKË

Rrihet në bastore 32 vjeçari

Të martën mbrëma, rreth orës 18.30 minuta, në repartin urgjent të spitalit të Gostivarit, është sjellë 32 vjeçari me iniciale D.K nga Gostivari me lëndime të shkaktuara me një objekt të fortë në shpatullën e majtë dhe në kokë. Lëndimet, sipas tij, para se të sillej në spital, i ka marrë në bastoren sportive që gjendet në rrugën “Tode Bogdanovski”, në Gostivar, në të cilën ka qenë me shokun e tij 38-vjeçarin me iniciale R.J ku ka hyrë E.N dhe ka tentuar që t’i merr 100 euro nga dora si dhe telefonin celularë dhe më pas të ikë. D.K ka kundërshtuar dhe pikërisht në momentin e kundërshtimit, E.N ka nxjerrë një thikë dhe dy herë e ka goditur në shpatull, pas çka me një sëpatë të vogël e ka goditur edhe në kokë dhe menjëherë e ka lëshuar vendin e ngjarjes. D.K-së i është ofruar ndihma mjekësore dhe është jashtë rrezikur për jetë dhe është lëshuar në mjekim shtëpiak. Është kryer hetim dhe po punohet në zbardhjen e plotë të rastit.

Arrestohet shtetasi shqiptar në Tetovë

Pjesëtarë të policisë nga Sektori për Punë të Brendshme në Tetovë, të martën mbrëma rreth orës 20.50 minuta, kanë privuar nga liria shtetasin shqiptarë me iniciale L.B 42-vjeçar, i cili pa lajmëruar ka qëndruar në rajon. Shtetasi shqiptarë është kapur në një kazino në lagjen “Vidoja Smilevski Bato”, në Tetovë, dhe pas arrestimit për një kohë të shkurtër është mbajtur në stacionin policorë në Tetovë, ndërsa më pas është dorëzuar në sektorin për kriminalitet ndërkufitarë migracion të huaj dhe riatdhesim, për procedurë të mëtejshme.

Vazhdojnë kontrollet në komunikacion

Dhjetë vetura të p regjistruara, 6 vozitës pa leje për vozitje, 4 vozitës fillestarë dhe 13 automjete të parkuara në mënyrë jo të rregullt, janë pjesë e kundërvajtjeve të komunikacionit të cilat të martën pjesëtarë të policisë nga Sektori për Punë të Brendshme në Tetovë, i kanë zbuluar në aktivitetet e kontrollit që janë realizuar në rajonin e Tetovës dhe Gostivarit. Këto dhe kundërvajtje të tjera janë rrumbullakuar me 18 dënime për kundërvajtje si dhe 25 fletëpagesa për gjobë.

Kujdes nga hajnat në vetura

Në rajonin e Pollogut ende është prezent dukuria e vjedhjes së gjësendeve me vlerë në automjete, por edhe vet vjedhja e automjeteve, andaj pronarët e automjeteve duhet që të jenë jashtëzakonisht të kujdesshëm ku dhe si i lënë automjetet si dhe sa i sigurojnë ato. Për shkak të kësaj, Sektori për Punë të Brendshme në Tetovë, sërish i rikujton pronarët e automjeteve që në mënyrë të detyrueshme të mbyllin automjetet e tyre pasi t’i parkojnë ato, të mos i lënë çelësat në bravat e dyerve dhe, përderisa kanë mundësi, në mënyrë cilësore t’i sigurojnë me pajisje adekuate. Pronarët e automjeteve gjithashtu këshillohen që në vende të dukshme të automjetit si në karrike ose në pjesën e përparme brenda automjetit të mos lënë çanta, laptop, telefona celularë, syze dielli, dhe gjësende të ndryshme me vlerë. Për shkak se pikërisht këto gjësende tërheqin sa më shumë vjedhësit, të cilët shumë shpejtë operojnë, gjegjësisht i thyjnë automjetet sidomos në orët e mbrëmjes, dhe më pas shumë herë më shpejtë edhe largohen nga vendi i ngjarjes pa lënë pas shumë gjurmë. Sektori për Punë të Brendshme në Tetovë edhe një herë apelon që këto vjedhje që kryhen në automjete, menjëherë të paraqiten në stacionin më të afërt policor, me qëllim që në kohë të ndërmerren masat efektive për zbulimin e autorëve të këtyre vjedhjeve dhe sanksionimin me ligj të tyre. (U.H)

LIDHUR ME PARALAJMËRIMIN PËR NDARJEN E AKREDITIMIT NGA EVOLUIMI

CILËSIA NUK VARET NGA FORMA, POR PËRMBAJTJA

Për prof.dr.Tahir Zajazi, nuk është gabim nëse Maqedonia i kthehet formës së mëhershme, pra kur për cilësinë në arsimin e lartë ekzistonin Këshilli i Akreditimit nga njëra anë dhe Agjencia e Evoluimit nga ana tjetër. Kështu edhe mund të jenë më rezistente karshi ndikimeve politike, ose kjo e fundit do ta ketë më të vështirë të diktojë interesat e veta te dy institucionet

Koha Laura PAPANIKU

Shkup, 6 dhjetor - Bashkimi gjashtë vite më parë i Këshillit të Akreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe Agjencisë për Evoluimin e Institucioneve të Arsimit të lartë, në një institucion të vetëm, nuk solli asnjë përmirësim sa i takon cilësisë. Këtë mendim, përveç ministres Renata Deskovkës, e cila ka paralajmëruar ndarje të Këshillit të Akreditimit dhe Evoluimit, në institucione të veçanta e mbështesin edhe njohësit e arsimit të lartë. Por, ata nënvizojnë se shumë më tepër se sa forma e organizimit të institucioneve, primare është pavarësia e mekanizmave që duhet të garantojë cilësinë e institucioneve të arsimit të lartë. Prof.dr. Tahir Zajazi, thotë se nuk është me rëndësi se si quhet institucioni apo nëse mekanizmat



përkatës instalohen në një, dy apo te institucione.

"E rëndësishme është që politika të qëndrojë jashtë sistemit të arsimit të lartë. Të mundësohet frymëmarrja e lirë e institucioneve qofshin ato universitete, këshille dhe të ngjashme. Cilido qoftë emërtimi i institucioneve që duhet të sigurojnë dhe kontrollojnë cilësinë, të ndara apo të bashkuara qofshin ato, duhet të kujdesen që të mos bien pre e politikës", pohoj Tahiri. Sepse, aty ku interesat ditore, pra të klasës politike, vihen mbi interesat e shkencës, mbi misionin dhe vizionin e universiteteve nuk mund të ketë përparim, shprehet ai. Prandaj sipas tij, pak rëndësi ka nëse mekanizmat e sigurimit dhe kontrollit të cilësisë do ti kemi në një institucion, sikurse është momentalisht apo do të ndahen në dy institucione të veçanta. Varianti i fundit, pra ky i ndarjes së KAE-së, veçmas për të siguruar cilësinë dhe veçmas për ta kontrolluar atë, në dukje le përshtypjen e një rregullimi më korrekt sa u takon mekanizmave kom-

petent për cilësinë e arsimit të lartë, plotëson më tej Zajazi. Nuk është gabim edhe nëse Maqedonia i kthehet formës së mëhershme, pra kur për këtë qëllim ekzistonin Këshilli i Akreditimit nga njëra anë dhe Agjencia e Evoluimit nga ana tjetër. "Kështu edhe mund të jenë më rezistente karshi ndikimeve politike, ose kjo e fundit do ta ketë më të vështirë të diktojë interesat e veta te dy institucione. Por, forma jo çdo herë garanton suksesin. E rëndësishme është përmbajtja", nënvizon Tahiri. Përvoja e deritanishme, sipas tij ka treguar se për interesat e veta politika gjen sa herë mënyrën për ti nënshtruar të gjitha institucionet për të cilat ka nevojë. Pak rëndësi ka se sa është numri i tyre. Dallimi qëndron në përpjekjet, nëse duhet të jenë të njëfishta, dyfishta apo shumëfishta, shpjegon ai. Bota është e ndarë në modelet dhe format me të cilat rregullohen mekanizmat për sigurimin e cilësisë dhe kontrollit të saj. Ka shumë shtete me sistem funksional të arsimit të lartë ku ata mekanizma veprojnë në një insti-



TAHIR ZAJAZI

E rëndësishme është që politika të qëndrojë jashtë sistemit të arsimit të lartë. Të mundësohet frymëmarrja e lirë e institucioneve qofshin ato universitete, këshille dhe të ngjashme. Cilido qoftë emërtimi i institucioneve që duhet të sigurojnë dhe kontrollojnë cilësinë, të ndara apo të bashkuara qofshin ato, duhet të kujdesen që të mos bien pre e politikës

tucion të vetëm, ashtu siç ka shumë shtete të tjera ku për to janë kompetente dy institucione,

Këshilli i Akreditimit në njërin amë dhe Agjencia e Evoluimit në anën tjetër. Pra problemi me mungesës e cilësisë në arsimin e lartë nuk qëndron te forma por te përmbajtja. Sa më të afta të fuqishme në aspektin e ngritjes profesionale të jenë institucione aq më e vogla janë gjasat e politeizmit, nënshtrimit dhe degradimit. Shtatë vite më parë, për shkak të keqpërdorimit të fondeve për implementimin e rrjetëve të mbështetura nga Komisioni Evropian, ishte sjellë vendim që Maqedonia të hiqet nga lista e shteteve kandidatë për sigurimin e projekteve të KE-së. Për të mbyllur skandalin e Këshillit të atëhershëm të Evoluimit, u soll vendim që ky institucion të bashkohet me Këshillin për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë. Por pavarësisht këtij hapi rregullativ, institucionet e arsimit të lartë nuk shënuan ndonjë rritje në cilësinë e studimeve dhe diplomave që ofrojnë. Kthimi në formën e para 2011-ës, nuk është garant për ndryshim thelbësor sa i përket sigurimit të cilësisë.

70 VJETORI I FAKULTETIT PEDAGOGJIK

Nxënësit e dobët të Pedagogjikut po dëmtojnë gjenerata të tëra!

Shkup, 6 dhjetor - Fakulteti Pedagogjik "Shën Klimenti i Ohrit" të mërkurën me Akademi solemne shënoi 8 Dhjetorin, festën e iluministit dhe mësuesit Shën Klimenti i Ohrit, si dhe jubileun - 70 vjet nga themelimi. Në dekadën e shtatë të ekzistimit fakultetit Pedagogjik "Shën Klimenti i Ohrit" në Shkup, identifikohet me probleme të mëdha. Në të, zakonisht regjistrohen studentët që nuk arrijnë të pranohen diku tjetër për shkak të suksesit të dobët, tha për gazetën Koha, Avzi Mustafa, profesor universitar në pension, duke apeluar deri tek autoritetet kompetentë të gjejnë mekanizma që të nxisin nxënësit e shkëlqyeshëm të shkollave të mesme të regjistrohen në Fakultetin Pedagogjik, pasi dy dekadat e fundit - këtu po regjistrohen ata më të dobët dhe si rezultat i kësaj kanë dëmtuar shumë gjenerata. "Fakulteti Peda-

"Në këtë fakultet shkojnë ata që gjejnë shansin e fundit ku nuk mund të regjistrohen në asnjë fakultet tjetër. Kjo është për të ardhur keq, është mëkat apo tragjedi", tha Avzi Mustafa

gogjik është një ndër fakultetet me shumë peshë në shoqëri për arsye se ai fakultet është fakultet ku i jep bazat e edukimit dhe arsimit të rinjve në shoqëri. Në këtë fakultet duhet gjithsesi të shkojnë studentët të cilët janë më të mirët në shkollat e mesme dhe për këtë besoj duhet të angazhohet MASH-i që të gjejë mekanizma për ti motivuar studentët më të mirë të studiojnë në këtë fakultet. Stimulimi duhet të jetë nëpërmjet bursave të ndryshme, punësimeve të menjëhershme, si dhe forma tjera që do ti motivojnë nxënësit të regji-

strohen këtu. Gjithashtu, për Fakultetin Pedagogjik kandidati përveç njohurive dhe diturive, duhet të ketë edhe aftësi muzikale, vizatimi e kështu me radhe, të jetë human, ti dojë fëmijët, të ketë një komunikim të lirshëm dhe gjithsesi - edhe pamja fizike e kërkon. Po këtu, siç dihet, në këtë fakultet shkojnë ata që gjejnë shansin e fundit ku nuk mund të regjistrohen në asnjë fakultet tjetër. Kjo është për të ardhur keq, është mëkat apo tragjedi", tha Mustafa. Ai mendon se duhet të rriten kriteret bazë për pranimin e stu-



dentëve në këtë fakultet dhe duhet të ulet numri i studentëve që pranohen. "Në të ardhmen, nëse në këtë fakultet do të kufizohet numri dhe do të pranohen gjithë ato të cilët meritojnë dhe kanë dëshirë të studiojnë në këtë drejtim, besoj se do të rregullohet çështja dhe të vijë ata që vlejnë e jo çdokush që nuk mund të regjistrohet në fakul-

tete të ndryshme, kthehet e regjistrohet veç për të marrë një diplomë. Sepse, kjo shkon në dëm si të vet atij studenti dhe pastaj të shoqërisë. Në universitetet e botës, sidomos në ato të Evropës Perëndimore, në fakultetin pedagogjik nuk mund të regjistrohet çdokush, ai duhet të posedojë disa aftësi tjera dhe të shpreh dashuri tërë për këtë profesion, i cili në të njëjtën kohë është profesion misionar jo vetëm që nxënësit të mund të fitojnë dituri, por të ketë edhe misionin e tij që të përhapë zhvillimin e njohurive diturive", u shpreh ai. Gjatë shënimit të këtij jubileu u promovua gjithashtu edhe monografia "70 vjet edukim, arsim, shkencë" nga prof. dr. Mito Spasevski. Me rastin e jubileut, Fakulteti Pedagogjik të enjten organizon lexim poetik, ndërsa të premtën edhe ekspozitë artistike në Çifte Hamam. (A.XH)

KOMISIONI PËR BUXHET SHQYRTON AMENDAMENTET E OPOZITËS



Zëvendësministrja e Financave, Shirete Elezi, në shqyrtimin e 12 amendamenteve të para nga gjithsej 204 të dorëzuar nga VMRO, e të cilat u shqyrtuan nga Komisioni për buxhet dhe financa, pranoi vetëm dy

VMRO BOJKOTON SEANCËN, PUSHTETI I PRANON AMENDAMENTE

Koha Zejnulla VESELI

Shkup, 6 dhjetor - Në ditën e dytë të Komisionit për buxhet dhe financa udhëhequr nga deputeti i LSDM-së, Vasko Kovačevski, anëtarët e Komisionit pa prezencën e deputetëve të partisë opozitare, filluan me shqyrtimin e amendamenteve të dorëzuara nga deputetët e VMRO-së lidhur me propozim-buxhetin për vitin 2018. Zëvendësministrja e Financave, Shirete Elezi, në shqyrtimin e 12 amendamenteve të para nga gjithsej 204 të dorëzuar nga VMRO, e të cilat u shqyrtuan nga Komisioni për buxhet dhe financa, pranoi vetëm dy. Pas përfundimit të debatit të djeshëm për buxhetin e vitit të ardhshëm, Vasko Kovačevski, si kryesues i Komisionit për buxhet dhe financa, kërkoi nga anëtarët e Komisionit të fillohet me shqyrtimin e të gjitha amendamenteve të dorëzuara edhe pasi propozuesit e amendamenteve nuk janë në sallë për të arsyetuar dhe mbrojtur amendamentet. Për kohë rekorde prej gjysme ore, anëtarët e Komisionit për buxhet shqyrtuan 12 amendamente, ndërsa zëvendësministrja Elezi pranoi dy amendamente. Amendamenti i parë që u pranua ka të bëjë me subvencionimin e qytetarëve, të cilët ambientet ku ata banojnë - do ti ngrohën me shporete me pelete. "Ministria e Financave e pranon këtë amendament dhe në Buxhetin e vitit të ardhshëm do të parashihen para për subvencionim e të gjithë atyre qytetarëve që do të blejnë shporet me pelete, ndërsa 50 për qind e çmimit të shporeteve do t'ju kthehen qytetarëve me kusht që vlera e shporetit mos të jetë më e lartë se 500 euro", tha Elezi. Amendamenti i dytë që u pranua ka të bëjë me kërkesën për më shumë mjete për ndërtimet e Zo-

navë të lira ekonomike me qëllim që të ndërtohet Zona e lirë ekonomike në Kumanovë. Zëvendësministrja Elezi u shpreh se edhe ky amendament pranohet, sepse siç tha ajo, edhe angazhimi i Qeverisë është që të ndërtohen Zona të reja ekonomike. Deputeti i BDI-së, Rexhail Ismaili, kërkoi që amendamenti për ndërtimin e Zonës së lirë të ndryshohet dhe të plotësohet në të kundërtën - nuk do ta ketë mbështetjen edhe të deputetëve të BDI-së. "Nëse amendamenti ndryshohet dhe plotësohet që me para buxhetore të ndërtohet Zona e lirë edhe në Likovë, atëherë edhe deputetët e BDI-së do të mbështesin miratimin e këtij amendamenti dorëzuar nga partia opozitare VMRO", tha Ismaili. Kërkesa e

deputetit Ismaili u aprovua nga anëtarët e Komisionit, të cilët kërkuan që amendamenti të ndryshohet nga propozuesi. Përveç VMRO-së, amendamente kanë dorëzuar edhe deputetët e Lëvizjes BESA dhe atë 75 amendamente dhe se shqyrtimi i këtyre amendamenteve, do të fillojë pasi të shqyrtohen të mbarojnë ato të VMRO-së. Komisioni do të punojë edhe gjatë tre ditëve të ardhshme dhe të dielën - më 10 dhjetor, duhet të mbyllet debati dhe anëtarët të votojnë propozim-buxhetin për vitin 2018. Në seancë plenare në Parlamentin e Maqedonisë buxheti më së voni në rend ditë duhet të jetë me datë 13 dhjetor, derisa debati në Parlament zgjat pesë ditë.

debat, ndërsa personalisht do të isha i lumtur nëse në seancën e komisionit vjen edhe opozita", theksoi Tevdovski pas eventit përfundimtar të BE, projektit i cili mundëson krijimin e një aplikacioni elektronik për pagimin më të thjeshtë të tatimit të të ardhurave personale.

BUXHETI PËR VITIN 2018 DO TË MIRATOHET NË KOHË

Ministri i Financave, Dragan Tevdovski, pret që buxheti për vitin 2008 të miratohet në kohë dhe deputetët e VMRO-DPMNE-së të kryejnë debatin në Komisionin amë të Parlamentit. "Besoj fuqishëm se buxheti do të miratohet. Shoh se është bllokuar puna e Komisionit. Për mua është e rëndësishme që të ketë

debat, ndërsa personalisht do të isha i lumtur nëse në seancën e komisionit vjen edhe opozita", theksoi Tevdovski pas eventit përfundimtar të BE, projektit i cili mundëson krijimin e një aplikacioni elektronik për pagimin më të thjeshtë të tatimit të të ardhurave personale.

Edhe gazetarët pjesë e Ligji për të falimentuarit

Shkup, 6 dhjetor - Sindikata e Paruarur e Gazetarëve (SPGM) dhe Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë (SHGM), e përshëndesin faktin që me ndryshimet e fundit të Ligjit për të falimentuarit përfshihen gazetarët nga radio stacionet e mbyllura lokale të cilët e

morën statusin e punëtorit të falimentuar dhe me atë të drejtën e kompensimit mujor deri në pensionim. "Me këtë pjesërisht u përmirësua një padrejtësi e madhe, me të cilën u përballën kolegët tanë kur brenda natës u mbyllën dhjetëra radio stacione

lokale dhe publike, ndërkaq ata mbetën pa punë dhe pa rrogë", qëndron në kumtesën e SPGM dhe SHGM. Siç sqarojnë, Ministria e Punës dhe Politikës Sociale i fuqizoi kërkesat e SPGM-së dhe SHGM-së, përfaqësuesit e të cilëve në gusht të këtij viti u

takuan me ministren e resorit, Milla Carovska. Në takim, përfaqësuesit e organizatave të gazetarëve kërkuan që gazetarët e falimentuar nga radio stacionet e mbyllura lokale të përfshihen me Ligjin e ri për të falimentuarit.

Policia pa uniformë!



Shkup, 6 dhjetor - Sindikata e Paruarur e Policisë (SPP) kërkoi që Ministria e Drejtësisë dhe Drejtoria për kryerjen e sanksioneve të angazhohen dhe të ndikojnë gjatë sjelljes së Buxhetit për vitin 2018 të zgjidhen problemet e policëve të burgjeve dhe administrata në burgjet. Kryetari i SPP-së, Goce Delčev Todev, të mërkurën para Ministrisë së Drejtësisë deklaroi se kërkesat, situata reale dhe problemet në policinë e burgjeve do t'i prezantojnë në takimin zyrtar me ministrin e Drejtësisë, së bashku me kryetarët në burgjet. "Njerëzit që janë policë të burgjeve dhe administratorë në policinë e burgjeve përballen me çështje serioze nga lloji i mospasjes së uniformës, orëve të punës, rregullimi i çështjeve në pajtim me Ligjin për marrëdhëniet e punës që të mos ndodhin padi dhe çështje lidhur me automjetet dhe transportin e personave të cilët janë në kryerje të detyrës. Nuk mund pagat dhe autorizimet të mos mbulohej me një vlerë të caktuar parash të planifikuar në pagesë", tha Todev. Ai theksoi se të gjitha komisionet dhe grupet e punës në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë do të duhet seriozisht të mendojnë dhe të dinë se, siç tha, nuk mund asnjë dokument i punës dhe ligj të kalojë pa vërtetim nga SPP-ja, i cili ka anëtarësi prej pothuajse 50 për qind nga policia e burgjeve dhe të punësuarit në burgje. Në kërkesat marrin pjesë nëntë nga gjithsej 12 burgje në Republikën e Maqedonisë, të cilët janë me organizata sindikale, në kuadër të SPP-së. (O.XH)

Vazhdon subvencionimi i kolektorëve diellor



Shkup, 6 dhjetor - Ministria e Ekonomisë edhe vitin e ardhshëm do të vazhdojë me subvencionimin e qytetarëve të cilët do të vendosin kolektorë diellor dhe do t'i ndërrojnë dritaret e vjetra prej druri me të reja PVC apo prej alumini me efikasitet energjetic, ndërsa risi do të jetë subvencionimi për blerjen e stufave me peleta për amvisëritë, para-

lajmëroi ministri i Ekonomisë, Kreshnik Bekteshi. Pas ribalancit, Ministria për këtë vit i ka marrë 16 milionë denarë për subvencionimin e vendosjes së dritareve me efikasitet energjetic, ndërsa janë subvencionuar 1.327 më shumë konsumatorë se vitin e kaluar. "Gjatë këtij viti janë subvencionuar edhe 1.794 qytetarë të cilët kanë vendosur ko-

lektorë diellorë që është për mbi 1.000 më shumë se vitet e kaluara", tha Bekteshi në konferencë shtypi në Qeveri, duke plotësuar se Ministria e Ekonomisë ka arritur në kohë t'i realizojë të gjitha kërkesat e subvencionuara. I pyetur nëse në tërësi do të pezullohen kufizimet për shitjen e alkoolit, ministri i Ekonomisë u përgjigj se negociatat zgjasin

akoma, ndërsa Ministria do të propozojë heqjen e kornizës kohore për shitje. Lidhur me procedurën për hapjen e minierës Kazandol, Bekteshi tha se janë respektuar të gjitha procedurat, ndërsa për pjesën për ndotjen e mjedisit jetësor, siç theksoi, kompetente është Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor.

EUROSTAT, 5 PËR QINDJETOJNË ME QIRA

SHUMICA ME KULM MBI KOKË



Banorët e Maqedonisë së bashku me ato të shteteve lindore kryesisht jetojnë në banesat që janë në pronësi të tyre. Nga ana tjetër, gati gjysma e popullatës në Evropë jeton në banesën që është pronë e tyre, ndërsa afër 30 për qind e popullatës jetojnë në banesat të vendosura nën hipotekë për të cilat paguajnë këstin e rregullt mujor në bankë, ndërsa pjesa e mbetur prej afër 30 për qind jeton me qira

Koha

Fisnik PASHOLLI

Shkup, 6 dhjetor - Banorët e Maqedonisë, së bashku me ata të shteteve lindore, kryesisht jetojnë në banesat që janë në pronësi të tyre. Nga ana tjetër, gati gjysma e popullatës në Evropë jeton në banesën që është pronë e tyre. Afër 30 për qind e popullatës jetojnë në banesat e vendosura nën hipotekë, për të cilat paguajnë këstin e rregullt mujor në bankë, ndërsa pjesa e mbetur prej afër 30 për qind jeton me qira. Nga ana tjetër, sipas të dhënave të statistikës vendore dhe zyrës evropiane të statistikave - EUROSTAT, familjet në Maqedoni, me 95 për qind posedojnë patundshmërinë ku jetojnë.

Baza e të dhënave të BE-së në lidhje me strehimin tregon se vendet ish-komuniste ku përfshihet edhe Maqedonia, trashëguan banesa në pronësi për shkak të çmimeve të ulëta, me të cilat i privatizuan ato gjatë rënies së sistemit. Ndër shkaqet e dallimit të madh midis anëtareve të reja dhe të vjetra, lidhur me pronësinë e banesës, janë edhe dallimet kulturore, migrimi, përqindja e lartë e banesave shoqërore që me të madhe janë ndërtuar në ish sistemin komunist që kanë kaluar në pronësi të ish banuesve të bllokut lindor për çmime të leverdishme etj. Sipas raportit për banim të organizatës ndërkombëtare "Habitat for Humanity", privatizimi i banesave shoqërore dhe ndërtimi

mi i madh i hapësirave banesore në ish sistemin komunist, kanë ndikuar që një pjesë e madhe e banorëve të Maqedonisë të jenë pronarë të hapësirës së tyre banesore.

"Maqedonia paraqet një shembull tipik të privatizimit të banesave shoqërore në shtete e ish sistemit socialist dhe ish shtetit jugosllav, që pas viteve 90-të sollën te situata që banuesit e këtyre shteteve të bëhen pronarë të banesave. Gati 80 për qind e fondit banesor në Maqedoni është ndërtuar midis viteve 1960 dhe 1980", theksohet në raportin e kësaj organizate kushtuar Maqedonisë.

Përqindje të lartë e pronësisë së banesës apo shtëpisë kanë edhe qytetarët e Shqipërisë. Sipas të dhënave të INSTAT, apo Institut të Statistikave të Shqipërisë në vitin 2016, 93 për qind e familjeve në Shqipëri ishin pronarë të banesave ku jetojnë, vetëm 5.5 për qind ishin me qira, ndërsa 1.5 për qind jetonin në shtëpitë që u kanë falur të tjerët ose e kanë në përdorim pa qira. Sipas këtyre treguesve, edhe shtetet e tjera lindore, si Rumania me 96 për qind, Sl-

lovakia, Kroacia dhe Lituania me nga 90 për qind, Hungaria me 88 për qind dhe Bullgaria me 84 për qind, kanë përqindje të lartë të qytetarëve që janë pronarë të hapësirës banesore. Statistikat krahasuese për posedimin e banesës tregojnë se shtetet e reja anëtare të BE-së dhe ish shtetet komuniste në pjesën dërmuese jetojnë në banesat e tyre. Nga ana tjetër, sipas EUROSTAT, përqindja më e ulët e qytetarëve që jetojnë në hapësirat e tyre banesore, nga shtetet anëtare të vjetra të BE-së, është në Gjermani me 52 për qind, Austri me 57 për qind, Danimarkë me 63 për qind, Britani e Madhe dhe Francë me 65 për qind, etj. Gjithashtu edhe në vendet nordike, ka një normë shumë të ulët të pronësisë ndaj shtëpi-ve. Në Norvegji vetëm 21.9 për qind e familjeve kanë në pronësi shtëpi, në Danimarkë

vetëm 15 për qind e tyre, në Hollandë 9.8 për qind dhe në Suedi vetëm 9.2 për qind. Danimarka, Holanda dhe Suedia, në të njëjtën kohë futen në vendet që kanë edhe numrin më të madh të banesave me qira, me përqindjet më të larta të të gjitha vendeve të anali-

zuara. Në Itali, situata është ndryshe. Një vend ku, tradicionalisht, familjet kanë luajtur një rol të rëndësishëm duke lënë trashëgimi shtëpi tek fëmijët. Në Itali, 57 për qind e familjeve janë pronare të shtëpive, ndërsa kjo përqindje arrin në 71 për qind, duke marrë në konsideratë shtëpitë e lëna peng në banka.

Në Bashkimin Evropian, një e katërta e popullatës jetojnë në patundshmërinë që është pronë e tyre (27.1 për qind) që kryesisht është e vendosur në hipotekë dhe për të cilat paguhen kësti dhe kamatat mujore. Nga ana tjetër, afër 43 për qind e evropianëve jetojnë në banesat që janë të paguara tërësisht tregojnë të dhënat e EUROSTAT, ndërsa pjesa tjetër e mbetur prej afër 30 për qind jeton me qira. Në fund është interesant të theksohen dhe të dhënat për përqindjen e amerikanëve që jetojnë në shtëpinë që e kanë në pronësi vetanake. Sipas të dhënave të vitit 2015 të Ministrisë amerikane të Tregtisë, niveli i amerikanëve që janë pronarë të shtëpisë së tyre ka rënë në 63.5 për qind, që paraqet nivelin më të ulët që nga viti 1980. Ulja e shkallës së pronësisë vjen si rrjedhojë e dëmeve të mëdha të recesionit, krizës së hipotekave dhe fryrjes së ballonit të patundshmërive, si dhe problemeve të tjera ekonomike. Shkalla më e lartë e pronësisë ka qenë 69.4 për qind dhe është regjistruar në vitin 2004.

Këmbimi tregtar, 10.9 miliardë dollarë

Shkup, 5 dhjetor - Gjithsej 10,9 miliardë dollarë është këmbimi tregtar i Maqedonisë në periudhën janar - tetor të vitit 2017, kumtoi Enti Shtetëror për Statistikë (ESHS). Eksporti është 4.658 miliardë dollarë dhe shënon rritje prej 16.9 për qind, ndërsa importi arrin 6.246 miliardë ose 12.2 për qind më shumë. Deficiti tregtar është 1.588 miliardë dollarë. "Këmbimi tregtar tregon se më shumë janë eksportuar katalizatorë të bartësve me materiale të çmuara ose komponimet e tyre, seta të telave për ndezje, për automobila, aeroplanë dhe anije, feronikel dhe veshje. Në import më të përfaqësuar janë platina dhe legurat e platinës, të papërpunuara ose pluhur, vajrat e naftës dhe vajrat e marra nga minerale bituminoze (përveç lëndët e para), metale tjera nga grupi i platinës dhe legurëve të saj, të papërpunuara ose në formë të pluhurit dhe energjia elektrike", thekson ESHS. Në periudhën janar-tetor të vitit 2017, sipas vëllimit të përgjithshëm të këmbimit, Maqedonia, më së shumti ka tregtuar me Gjermaninë, Britaninë, Greqinë, Serbinë dhe Bullgarinë.

Rriten shpenzimet në ndërtimtari

Shkup, 6 dhjetor - Shpenzimet në ndërtimtari për banesa të reja në tremujorin e tretë nga viti 2017 në krahasim me tremujorin e dytë, janë më të larta për 0.9 për qind, shpenzimet për materiale janë më të ulëta për 0.3 për qind, ndërsa shpenzimet për të punësuarit janë rritur për 3.7 për qind. Në tremujorin e tretë të vitit 2017, ndërkaq, në krahasim me tremujorin e tretë të vitit të kaluar, shpenzimet në ndërtimtari për banesa janë më të larta për 3.3 për qind, shpenzimet për materiale janë më të larta për 2.1 për qind dhe shpenzimet për të punësuarit janë më të larta për 5.9 për qind.

"Endava" do të punësojë edhe 200 persona

Shkup, 6 dhjetor - Kompania IT britanike "Endava" e shënon trevjetorin e hapjes së zyrës së saj në Shkup në të cilën për momentin punojnë 190 persona, ndërsa planifikohet deri në vitin 2020 numri i tyre të arrijë deri në 400. "Për tre vjet kemi bërë shumë dhe ndërtuam një kompani të fuqishme në Maqedoni në të cilën ka persona profesional të cilët kanë

dëshirë që për çdo ditë ta përmirësojnë diturinë e tyre. Mundohemi të jemi të suksesshëm sepse suksesi ynë sjell sukses dhe të klientëve tanë", tha Ilija Gospodinov, udhëheqësi i "Endava"-s në Maqedoni në konferencën e së mërkurës për shtyp. Ai theksoi se zyra në Shkup bashkëpunon me më shumë se 70 klientë nga mbarë bota prej të cilëve pjesa më

e madhe janë nga Evropa perëndimore dhe Amerika veriore. Mënyheri i "Endava"-s në Maqedoni Remi Savu theksoi se ekspertët e TI me përvojë dhe studentët të diplomuar kanë mundësi për karrierë të shkëlqyer dhe zhvillim të vazhdueshëm në kompaninë në Shkup. Ai theksoi se kompania ofron programe për praktikë kuadro TI, për studentët të diplomuar

dhe për rikualifikim profesional dhe ka platformë interne për trajnim dhe program për plan të karrierës për secilin të punësuar. Për hapjen e zyrës në Maqedoni, siç tha, kanë vendosur sepse ka rreth 5.000 inxhinierë dhe çdo vit prodhohen nga 500 të rinj. "Endava" është kompani e parë TI e themeluar në vitin 2000 si investim evropian. Në të punojnë më

shumë se 4.000 persona në 14 vende në Evropë dhe Amerikë. Shtet zgjidhje TI për klientë në fushën e financave, sigurimit, telekomunikimeve, mediave, teknologjisë dhe shitjes me pakicë. Në Maqedoni kompania hapi zyrë në vitin 2014 me 28 të punësuar, në vitin 2015 numri i tyre u rrit në 111, ndërsa në vitin 2016 arriti deri në 150.

Në Tetovë gjithsej ka 7 semaforë të vendosur në udhëkryqe, kurse për vitin që vjen janë planifikuar riparime të të njëjtave dhe vendosjen e një semafori në rrugën te Tetovarja

KOLONA DHE PENGESA NË KOMUNIKACION

POLICIA TËRHEQ KËRKESËN PËR SEMAFORËT



Koha Urim HASIPI

Tetovë, 6 dhjetor - Më shumë se dy javë, në Tetovë, disa nga semaforët në bulevardet kryesore kanë qenë jashtë funksionit. Ndonëse tashmë në qytetin e Tetovës ka shumë pak semaforë, sidomos me ndërtimin e rrethrotullimeve, megjithatë edhe ato pak që janë ndodh që të jenë jashtë funksionit. Sipas informacioneve, ka qenë kërkesë e policisë, gjegjësisht Stacionit për Siguri në Komunikacionin rrugor në Tetovë, që semaforët të jenë jashtë funksionit, me qëllim që të mos shkaktohen kolona dhe pengesa në komunikacion. Këtë e ka bërë të ditur ndihmës udhëheqësi i Sektorit për Veprimtari Publike në Tetovë, Memet Jonuzi.

Ai tha se semaforët nuk kanë

qenë në defekt, por vetëm ka qenë kërkesë e policisë. "Është e vërtetë se semaforët nuk kanë qenë në funksion. Kjo ka qenë me kërkesë të Policisë së Komunikacionit. Ne kemi pasur gjithmonë bashkëpunim me policinë dhe kemi respektuar kërkesën e tyre që semaforët të jenë jashtë funksionit. Nuk bëhet fjalë për defekte, sepse të njëjtit kanë qenë në gjendje të rregullt dhe vetëm kemi respektuar bashkëpunimin që kemi me poli-

cinë", deklaroi Memet Jonuzi, ndihmës udhëheqësi i Sektorit për Veprimtari Publike në Tetovë.

Sipas tij, kërkesa është parashtruar nga policia, me qëllim që të evitohen gjithnjë sipas tyre, kolonat e gjata të automjeteve në bulevardet kryesore. Më pas kemi pranuar kërkesë që të ndërpritet kjo masë dhe të vendosen sërish në funksion semaforët. Në ndërkohë, sipas informacioneve të Stacionit për Siguri në Komunikacionin rru-

gor në Tetovë, ka qenë kërkesë e tyre që semaforët të jenë jashtë funksionit dhe në atë të rast të vlejnjë shenjat e komunikacionit. Sipas tyre, përgjatë kohës sa kanë qenë jashtë funksionit nuk ka pasur pengesa më të mëdha në zhvillimin normal të komunikacionit, sidomos në Bulevardin e Ilindenit dhe rrugën Industriale. "Gjatë kohës së fundit në Bulevardin e Ilindenit dhe Vidoja Smilevski Bato, ka pasur pengesa në zhvilli-

min normal të komunikacionit, gjegjësisht kolona të gjata të vetura. Vlerësimi ynë ka qenë që semaforët të jenë jashtë funksionit apo rolit që kanë dhe në ato vende të vlejnjë rregullat sipas shenjave të komunikacionit që janë në ato udhëkryqe", tha Besir Qamili, zëvendëskomandant në Stacionin Policor për Siguri në Komunikacionin rrugor në Tetovë. Megjithatë, sipas policisë, pas akuzave dhe kritikave të shumta nga qytetarët, ata kanë vendosur që të tërheqin kërkesën që semaforët të jenë jashtë funksionit.

"Mirëpo, kemi pranuar shumë ankesa dhe kritika për këtë veprim dhe kemi vendosur që të tërheqim vendimin. Tash në ato pjesë ku do të ketë kolona dhe pengesa në zhvillimin normal të komunikacionit do të vendosim polic rrugor nëse kërkohet. Mendimi ynë është se masa e përkohshme që semaforët të jenë jashtë funksionit ka pasur efekte pozitive, por tash e tutje si do veprohet në këto situata pritet të kemi koordinime shtesë", deklaroi Qamili. Në ndërkohë, në Tetovë gjithsej ka 7 semaforë të vendosur në udhëkryqe, kurse për vitin që vjen janë planifikuar riparime të të njëjtave dhe vendosjen e një semafori në rrugën tek Tetovarja. Në dekadën e fundit në Tetovë, kryesisht në rrugët kryesore, janë larguar semaforët dhe janë vendosur rreth-rotullime.

ME VENDIM TË SENATIT TË UNIVERSITETIT TË TETOVËS

LAZIM DESTANI MERR TITULLIN DOCTOR HONORIS CAUSA



Tetovë, 6 dhjetor - Në Tetovë, me rastin e përvjetorit të Universitetit shtetëror të Tetovës, me vendim të Senatit të Universitetit, z. Lazim Destani u dekorua me titullin Doctor Honoris Causa. Në referatin për shpalljen e vendimit nga ana e Universitetit u tha se bëmat dhe veprat e Lazim Destanit kapërcëjnë vetë referatin dhe atë që mund të shprehet përmes leksemave ekzistuese gjuhësore.

"Profili i tij prej humanisti dhe atdhetari nuk mund të përmblihet thjesht vetëm në një sekuencë të shkruar të formës gjuhësore, por arrin spektrin e hyjnore dhe të përjetshmes." – tha prorektori i UT-së dhe anëtar i komisionit recensues Arbër Çeliku, gjatë leximit të vendimit.

Lazim Destani gjatë fjalimit të tij pas pranimit të titullit tha se ndjehet i nderuar që ky çmim iu nda atij dhe se kjo nuk i takon vetëm atij por një rrethi më të gjerë njerëzi-

sh duke filluar nga familja e tij e deri te bashkudhëtarët tjerë në karrierën e tij, që sipas tij nuk janë të paktë. Ai theksoi edhe se përpjekjet dhe sakrificat për ngritjen e këtij Universiteti janë akoma të freskëta në memorie. Lazim Destani është i njohur për aktivitetet filantropike në rajon, diasporë dhe më gjerë, ai madje sheh filantropinë si formë adresimi sfidash.

"Për ta çuar përpara ekonominë dhe shoqërinë në përgjithësi, filantropia paraqet një fushë të rëndësishme aktivitetesh dhe meriton vëmendjen e afaristëve. Afarizmi gjithsesi mbetet gjenerator i rëndësishëm për zhvillimin e një vendi, por filantropia është po ashtu një vegël kyç për adresimin e sfidave të shoqërisë dhe është shumë më shumë sesa bamirësia", tha filantropi Destani në përmblyllje të fjalimit të tij me rastin e dekorimit me titullin Doctor Honoris Causa nga ana e Universitetit Shtetëror të Tetovës.

Publicitet

Në bazë të nenit 131 paragrafi (1) dhe (2), të Ligjit për arsim sipëror ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 35/08, 103/08, 26/09, 83/09, 99/09, 115/10, 17/11, 51/11, 123/12, 15/13, 24/13, 41/14, 116/14, 130/14, 10/15, 20/15, 98/15, 154/15, 30/16, 120/16 dhe 127/16), neneve 34 dhe 35 të Rregullores për kriteret dhe procedurën për zgjedhje në titujt mësimor-shkencor, shkencor, mësimor-profesional dhe bashkëpunues dhe asistentë – doktorantë të Universitetit "Shën Kirili dhe Metodi" në Shkup (Fletorja universitare nr. 138/2009, 140/2009, 173/2011, 194/2011, 250/2013 dhe 274/2013), Fakulteti i medicinës në Shkup, në kuadër të Universitetit "Shën Kirili dhe Metodi" në Shkup, publikon

KONKURS

Për zgjedhje në titujt mësimor – shkencor, shkencor dhe titullar dhe asistentë-doktorantë

- I. MEDICINA INTERNE**
 - 1 mësimdhënës në të gjitha titujt mësimor-shkencor, në sferat mësimore-shkencore:
 - Medicina interne;
 - Pulmologji me ftiziologji.
 - 1 mësimdhënës në të gjitha titujt mësimor-shkencor, në sferat mësimore-shkencore:
 - Medicina interne;
 - Toksikologjia.
 - 6 asistentë – doktorantë
- II. SËMUNDJET INFEKTIVE**
 - 1 mësimdhënës në të gjitha titujt mësimor-shkencor, në sferat mësimore-shkencore:
 - Infektologji;
 - Sëmundjet tropikale dhe karantine.
 - 1 person në të gjitha titujt shkencor në sferat shkencore:
 - Infektologji;
 - Sëmundjet tropikale dhe karantine.
 - 3 asistentë – doktorantë
- III. ORTOPEDI**
 - 1 person në thirrjen titullare, në sferën mësimore-shkencore sëmundjet ortopedike.
- IV. FIZIOLOGJIA PATOLOGJIKE**
 - 1 mësimdhënës në të gjitha titujt mësimor-shkencor, në sferat mësimore-shkencore:
 - fiziologjia patologjike;
 - medicina nukleare.
- V. GJINEKOLOGJIA DHE OBSTETRIKË**
 - 8 asistentë – doktorantë
- VI. KIRURGJI**
 - 18 asistentë – doktorantë
- VII. RADIOLOGJI**
 - 3 asistentë – doktorantë
- VIII. NEUROLOGJI**
 - 7 asistentë – doktorantë
- IX. PEDIATRI**
 - 7 asistentë – doktorantë
- X. DERMATOVENEROLOGJI**
 - 4 asistentë – doktorantë
- XI. OFTALMOLOGJI**

- 1 asistentë – doktorantë
- XII. PSIKIATRI DHE PSIKOLOGJI MEDICINALE**
 - 2 asistentë – doktorantë
- XIII. TRANSFUZIOLOGJI**
 - 1 asistent – doktorant

Kushtet: Kandidatët, krahas kushteve të përgjithshme, duhet ti plotësojnë edhe kushtet e posaçme të parapara me Ligjin për arsim sipëror, Ligjin për veprimtari shkencore – hulumtuese, Rregulloren për kriteret dhe procedurën për zgjedhje në titujt mësimor-shkencor, shkencor, mësimor-profesional dhe bashkëpunues dhe asistentë-doktorantë të Universitetit "Shën Kirili dhe Metodi" në Shkup dhe me aktet tjera të Fakultetit dhe Universitetit.

Së bashku me fletëparaqitjen kandidatët duhet të dorëzojnë: biografi të shkurtë, dëshmi për plotësim të kushteve të përgjithshme dhe të posaçme dhe certifikatë të shtetësisë, ndërsa për asistentë-doktorantë edhe vërtetim – certifikatë për njohje të gjuhës angleze edhe atë: (TOEFEL) – së paku 74 pikë për dhënie të provimit elektronik përmes kompjuterit jo më të vjetër se dy vjet nga dita e dhënies; (IELTS) – së paku 6 pikë jo më të vjetër se dy vjet nga dita e dhënies; (TOLES) – njohje bazike (Foundation level); (ILEC) – të dhënë me sukses së paku B2 ose Kembrixh certifikatë për gjuhë angleze preliminare (Cambridge Certificate of Preliminary English) - (B1).

Konkursi zgjatë 8 ditë nga dita e publikimit. Fletëparaqitja me dokumentacion të kompletuar dorëzohet në arkivin e Universitetit "Shën Kirili dhe Metodi" në Shkup, Fakulteti i medicinës – Shkup në rr. 50-ta Divizija nr. 6, Shkup.

Fakulteti i medicinës – Shkup, Universiteti "Shën Kirili dhe Metodi" në Shkup

Marrëveshja me Malin e Zi

Augustin PALOKAJ



Papërgjegjësia, prepotenca, vetëbesimi i tepruar, neglizhenca, diletantizmi politik, naiviteti, papërvoja, mungesa e njohurive apo interesat personale mund të kenë qenë ndër arsytet për shkak të së cilave Kosova erdhi në një pozitë të paprecedentë që duhet ta ratifikojë një marrëveshje për demarkacionin e kufirit me Malin e Zi si një prej dy kushteve të mbetura për liberalizimin e vizave. Nuk mund të hyjmë tash, dhe nuk ka nevojë, në analiza se a ka humbur apo jo Kosova tokë me këtë marrëveshje, a kanë të drejtë ata që janë në favor apo ata që janë kundër saj. Kjo për të ardhmen e Kosovës dhe për fatin e liberalizimit të vizave më nuk ka kurrfarë rëndësie. Nuk ka më as hapësirë për eksperimente, as për kalkulime politike, as për përmirësime të gabimeve. Kosova edhe një herë, sikur më parë edhe në rastin e kufirit me Maqedoninë, demarkacionin e së cilit u desh ta bënte sipas marrëveshjes që kishte bërë Serbia, si kusht nga Pakoja e Ahtisarit dhe çmim për shpallje të Pavarësisë, e në një mënyrë edhe për njohje nga Maqedonia, tash duhet ta bëjë ratifikimin e kësaj marrëveshjeje me Malin e Zi. Kthim prapa as nga BE-ja e as nga Mali i Zi nuk do të ketë. Pra, BE-ja nuk do të heqë dorë nga kushti të cilin, pa të drejtë, e ka vendosur dhe përmendur publikisht. E Mali i Zi e konsideron këtë si çështje të kryer. Pra, pa pajtimin e Malit të Zi Kosova nuk mund ta vërë këtë çështje në arbitrazh, sepse në to mund të shkohet vetëm së bashku, ndërsa Kosova pa qenë anëtare e OKB-së nuk mund t'i drejtohet as Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë. Humbi apo jo tokë Kosova, duhet tash ta ratifikojë këtë marrëveshje. Dhe ky është përsëri një shantazh ndaj Kosovës, jo për shkak të përmbajtjes së marrëveshjes, por për shkak të mënyrës se si bëhet presion që ajo të ratifikohet. Pasi është humbur aq shumë kohë dhe nuk është ndryshuar asgjë, Kosova vetëm mund të humbë edhe më shumë kohë. Dhe kurdo që të ratifikohet do të thuhet se është humbur kohë e panevojshme. Dhe ata të cilët e kanë shkaktuar këtë vonesë do të fajësohen për dështimin në procesin e liberalizimit të vizave e jo ata të cilët për më shumë se tetë vjet nuk i kanë përmbushur kushtet e tjera që një gjë e tillë të arrihet. Prandaj ka qenë edhe një veprim jashtëzakonisht i zgjuar i PDK-së që në këtë moment t'i afroje Ramush Haradinajt postin e kryeministrit që atij dhe partisë së tij, dikur ndër kundërshtarët më të mëdhenj të de-

markacionit, jo vetëm t'i hidhet një pjesë, por i gjithë fajit për dështim në liberalizimin e vizave dhe, nëse kalon ratifikimi, përgjegjësia se po ratifikohet një marrëveshje që në një pjesë të madhe të opinionit është perceptuar si e dëmshme për Kosovën. Kosova nuk ka më asnjë rrugëdalje nga kurthi i kurdisur përmes Marrëveshjes për kufirin me Malin e Zi pos ta ratifikojë atë. Nuk ka asnjë arsytim logjik se pse ky u bë kusht për liberalizimin e vizave dhe ka dhjetëra shembuj krahasues që dëshmojnë se ky kusht është i padrejtë dhe diskriminues e shantazhues ndaj Kosovës dhe qytetarëve të saj. Dhe sa herë që i përballim zyrtarët e lartë të BE-së me këto fakte, ata në fund kanë këtë arsyetim: "Vetë autoritetet e Kosovës janë pajtuar që ky të jetë kusht dhe kanë garantuar se i kanë votat që ta ratifikojnë në Kuvend".

Do të ishte e tepërt të thuhet se vetë Qeveria e Kosovës kishte kërkuar që ratifikimi i Marrëveshjes së demarkacionit të bëhej kusht. Por në BE, përfshirë edhe vetë komisionerin për fqinjësi dhe negociata të zgjerimit, Johannes Hahn, kanë konfirmuar se "pala kosovare është pajtuar vetë me këtë kusht". Burimet e BE-së kanë thënë se nga niveli më i lartë i Kosovës u

ishte thënë se "kjo është vetëm një çështje teknike" dhe se pa problem do ta kalojnë në Kuvend, ku i kanë votat e nevojshme. Duhet rikujtuar se zgjidhja e kontesteve kufitare nuk ka qenë kusht për asnjë vend të rajonit për asgjë. Kroacia ka çështje të hapura kufitare me të gjithë fqinjët pos me Hungarinë. Bosnjë-Hercegovina me Kroacinë, Mali i Zi me Kroacinë po ashtu. BE-ja ka kërkuar vetëm dëshmi se këto çështje do të zgjidhen në mënyrë paqësore, përmes marrëveshjeve të vetë shteteve mes vete, apo nëse një gjë e tillë nuk do të jetë e mundur atëherë përmes organizmave ndërkombëtarë, arbitrazhit apo Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë, e jo me dhunë.

Madje, siç kemi parë në një draft të strategjisë për zgjerimin dhe Ballkanin, për të cilin "Koha Ditore" ka shkruar ekskluzivisht të shtunën, përfundimi i demarkacionit për vendet e rajonit nuk do të jetë kusht as për anëtarësim të plotë në BE, ndonëse kërkohet në këtë dokument që të gjitha shtetet t'i kenë kryer çështjet e hapura kufitare me fqinjët para se të hyjnë në BE. Këtu përmendet mundësia që deri në atë moment ose t'i kenë kryer, ose t'i kenë dorëzuar para organizmave ndërkombëtarë, si arbitrazhi

Kosova nuk ka më asnjë rrugëdalje nga kurthi i kurdisur përmes Marrëveshjes për kufirin me Malin e Zi, pos ta ratifikojë atë



apo Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë. Pra, mundësia që vendeve të tjera të rajonit u jepet deri në anëtarësim në BE, Kosovës nuk i është dhënë as për liberalizim vizash. Kushti i kufirit me Malin e Zi vërtet përmendet në udhërrëfyesin për liberalizimin e vizave, por është shkruar në atë mënyrë që lë të interpretohet edhe se ai tashmë është përmbushur. Ky kusht përmbledhet në këtë fjali anglisht: "Endeavour to complete, in a co-ordinated manner with the other party, the delineation of the border/boundary with Montenegro; (Përpjekje për të kompletuar në mënyrë të koordinuar me palën tjetër shënjimin e kufirit, vijës administrative me Malin e Zi).

Leximi dhe kuptimi i kësaj mund të bëhet edhe me konstatimin se Kosova e ka përmbushur atë. Sepse nuk përmendet ratifikimi, por vetëm "endeavour", që do të thotë pak a shumë "të bëhen përpjekje maksimale" për kompletimin e shënjimit të vijës administrative/kufirit. Nuk ka dyshim se Kosova ka bërë përpjekje maksimale për këto probleme, siç shihet nga rastet e tjera në rajon, por janë vështirë të zgjidhshme edhe kur bëhen përpjekje maksimale. Prandaj edhe duhet të shihet si e padrejtë që tash ky kushtëzim të ngrihet në nivelin e

KOHA PËR KARIKATURËN E DITËS



Themelues: Arben Ratkoceri dhe Lirim Dullovi

Botues: Koha Production SHPK | Adresa e botuesit dhe redaksisë: Bul. Goce Delçev nr.11, | Q.T. Mavrovashja lok.14 - përdhësë, Shkup | Gazetë ditore - botohet çdo ditë përveç të dielës | Shtypi dhe distribuimi: "Adria Media Balkan" - rr. 852 nr.62, Shkup, 5000 kopje | Data e shtypjes e mërkurë 6 dhjetor | Numri i parë i gazetës doli më 22 Nëntor 2006
 Drejtor: LIRIM DULLOVI | Kryeredaktor: Vedat MEMEDALIU | Ndhimskryeredaktor: Evis HALILI | Redaktorë: Shkëlzen HALIMI | Redaktor teknik: Halil BERISHA
 E-mail: koha@koha.com.mk | Tel: 02 3179 - 904; Tel: 02 3179 - 905; Tel: 02 3179 - 906; Fax: 02 3118 - 060; | MARKETING: Bekim SHAQIRI • marketing@koha.com.mk; Tel: 02 3179-904; Mob: 071 372 222 | Përgjegjës për distribuim: Afrim DULLOVI - Tel: 071 372 221
 Përfaqësues ligjor: Shtëpia e avokatëve Inter Partes - Shkup

NPK "Koha Production" Num. i xhironlogarisë: 210063340670177; Tutunska Banka -Shkup; Numri tatimor 4030008022772

kërkimit të ratifikimit. Ndërkaq kur u dha nga Komisioni Evropian rekomandimi i kushtëzuar për liberalizim kjo u shndërrua në ratifikim të kësaj marrëveshjeje, por para se të hyjë në fuqi liberalizimi. Më vonë ky kusht u avancua për të filluar procedurat. BE-ja ka mundur lirish ta përmbyllë procesin, të marrë vendimin formal për liberalizimin e vizave, ta botojë në gazetën zyrtare, dhe pastaj hyrjen në fuqi ta kushtëzojë. Por, duket se dikush qëllimisht ka dashur tërësisht ta ndalë procesin në pritje të lëvizjeve nga ana e Kosovës duke ua bartur përgjegjësinë e plotë autoriteteve të Kosovës. Por, siç e dimë nga përvoja, kur BE-ja e bën kusht formal një gjë, atëherë nuk tërhiqet, sidomos jo në rastin e Kosovës për të cilën nuk ndien se i ka ndonjë borxh apo ndonjë nevojë që të arsyetohet ndaj qytetarëve të saj. Problem që mund t'i paraqitet Kosovës në rrugën e mbetur të liberalizimit të vizave, në rast se përmbushet kushti i ratifikimit të Marrëveshjes me Malin e Zi, është lufta kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar. Ky kusht nuk është përmbushur ende, edhe pse zyrtarët kosovarë mendojnë se ai është "lehtë i tejkaluar". Në BE po rritet dyshimi se Kosova ka ngecje në luftë kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit në nivel të lartë.

Për ta dëshmuar të kundërtën nga Kosova kërkohen dënime nga ana e gjykatave, por edhe konfiskime të pronës atyre të cilëve deri tek to kanë ardhur përmes veprimeve kriminale. Për të dhënë këto dëshmi, në rastin më të mirë, përpos vullnetit politik dhe guximit të prokurorëve dhe gjykatësve, duhet edhe kohë. Prandaj edhe nëse përmbushet kushti i ratifikimit të Marrëveshjes me Malin e Zi, do të kalojë një kohë deri tek liberalizimi i vizave dhe një gjë e tillë nuk do të ndodhë shpejt. Duke pasur parasysh se edhe BE-së do t'i duhen disa muaj procedurë, në rastin më të mirë liberalizimi mund të ndodhë nga fundi i vitit 2018 apo diku në vitin 2019. Gjithmonë ekziston rreziku që nga BE-ja, në mënyrë ta hapur apo të fshehtë, të vendosen edhe kushte të reja. Tashmë nga disa diplomatë po përfillet se do të pritet edhe krijimi i Asociacionit të komunave me shumicë serbe në Kosovë dhe dëshmi për bashkëpunim "të plotë dhe të pakusht" të autoriteteve të Kosovës me EULEX-in dhe Gjykatën Speciale. Çfarëdo që të ndodhë do të jenë ende qytetarët e Kosovës ata që do t'i ndiejnë pasojat.

Qeveria si vendstrehim politik

Xheladin MURATI



Të gjithë luftojnë dhe vrapojnë për Qeveri. Aty e gjejnë komoditetin, leverdinë, interesin. Ajo, siç duket, shërben për transferatë të fshehura, që gjithsesi duhet të jetë e pabazë. Një gjë është e sigurt, pjesëmarrja e të gjithave partive në Qeveri siguron stabilitet por pa aftësi korrektuese. Kësisoj Qeveria bëhet teatër me aktorë të ndryshëm, por nuk luan role teatrore, ajo njëherit është si një familje ku ka fëmijë të përkëdhelur dhe rebel, të pakënaqur me kryefamiljarin. Kjo gjendje i disperzon forcat e Qeverisë për vendimarrje serioze. Thjesht, aty plas dhe sherri. Madje, sherri në Qeveri është më i rrezikshëm. Padyshim, secila nga partitë tona shqiptare e maqedonase dëshirojnë të futen në qeveri. Qeverinë e konsiderojnë si parajsë. Të gjitha shprehin shqetësime pse nuk janë pjesë e saj. A është kjo vallë shenjë se pjesëmarrja do të siguroj se s'do të abuzohet me to apo nuk paraqesin rrezik moral për nëpërkëmbjen e tyre. Solidariteti i kryeministrit është i pranishëm, ai do numra dhe pajtime politike, ai do vota dhe jo kundërshtime. Lufta për pjesëmarrje në Qeveri, tregon interesa të shumanshme. Rreziqet për mospjesëmarrje në Qeveri janë të larta për shtetin, për qytetarët. Në radhë të pare afirmohet një nacionalizëm i tepruar dhe i pabazë maqedonas, mandej rritja e kërcënime-

ve të stabilitetit të shtetit e të ngjashme. Kështu mendon opozita maqedonase, e cila gjithnjë ngjallë urrejtje dhe mllef. Mospjesëmarrja në Qeveri nuk duhet të krijoj frikë as për partinë, as për qytetarët. Politikanët mund të frikohen për ardhmërinë e tyre. Në këtë kontekst Qeveria mund të kapërcej frikën nëse lidhshipi i saj do të jetë më konsekuent, pa anime, më korrekt dhe më transparent ndaj të gjithëve. Por edhe më i vendosur, mos i zvarrit punët. Qeveria, edhe pse e ka marrë atributin reformatore, ajo është larg reformimit cilësor të jetës e të marrëdhënieve njerëzore e shoqërore në vend. Sepse, asaj i mungon oferta e sinqertë për zhvillim. Në fakt ajo mundohet të krijojë një balance në mes kërkesave të partive politike dhe votuesve. Kjo për arsye se qytetarët janë opozitë e vërtetë e saj. Partitë bëjnë vetëm pazaret nga interesi personal. Prandaj Qeveria nuk mund të bën "boom", siç premtoi me formatimin e saj fillestar. Asaj i nevojitet diplomaci pragmatike, sjellje e ftohtë dhe arrogante ndaj gjithë atyre që parashtrojnë kërkesa absurde, madje vetëm të iniciuara nga interesa të ngushta personale apo grupore. Këto dhe rrethanat e tjera bëjnë që Qeveria mos të jetë kohezive, kompakte, shpresëdhënëse. Kjo për arsye të populizmit. Populistët bën premtime që s'mund t'i mbajnë. Premtimet nuk ishin në për-

Qeveria, edhe pse e ka marrë atributin reformatore, ajo është larg reformimit cilësor të jetës e të marrëdhënieve njerëzore e shoqërore në vend. Sepse, asaj i mungon oferta e sinqertë për zhvillim



puthje me racionalitetin dhe interesin politik apo vetanak. Prandaj, Qeveria humb besueshmërinë. Ata pretendojnë se janë reformues, por pse votuesit duhet t'u besojnë liderëve që nuk janë ndryshe nga të parët. Ndodh edhe kjo që Qeveria synon të kujton në shenjë e pajtimit të armiqve të betuar të dikurshëm e të sotëm (Boshkovskin dhe Zaevin, Boshkovskin e Ahmetin, BDI-në dhe PDSH-në). Mendoj se prapa vendimeve të këtilla fshihet, ndoshta, ndonjë filozofi e politikës sistemore dhe besoj se hapat e tyre janë fryt i ndonjë arsyeje apo kompromisi shtetëror, që është i domosdoshëm për praktikën e politikës ditore. Megjithatë, Qeveria është bërë nënë për dike e njerë për tjerët. Së fundmi mendoj se kryeministri duhet të jetë i përgatitur të blejë dhe blerje të shtrënjta të aktorëve politikë. Ai duhet të stërvitë lojtarë politikë, të cilët kanë një talent të jashtëzakonshëm për të bërë politikë, në mënyrë që të mbijetojnë skemën politike. Ky është një proces që zgjatë me vite. Por, më mirë ky sesa të luftosh të dekompozosh parti të vogla (ASH, BESA) ose t'i minimizosh ato për hire të qetësisë në shtëpi. Dhe krejt në fund, është talenti Zaev në tejkalimin e ndasive. Ndërsa shqiptarët vazhdojnë të debatojnë mes veti se çdo të thotë të jesh shqiptarë. Ose do i bësh shqiptarët lsdm-ista ose ata do te rebelohen, s'ka rrugë tjetër për paqen në Qeveri.

NË SHIRITIN E KOHËS

Prefektura ku?

Ku do të ngrihet godina e re e prefekturës? Në "hyqymetin" e vjetër, në bulevardin e madh, apo ku? Prefekti, që e mori përsipër si inisiator i kësaj veprë të lavdërueshme, heshti dhe hesht. Ai nuk do të ikë nga Korça pa filluar punën, pa hedhur të paktën themelet e prefekturës së re.

Se kushdo që ka qeverisur Korçën, e ka menduar mirë këtë gjë, ka dashur të ngrejë ndërtesën qeveritare, po për arsye të ndryshme dhe grindjet që ushfaqën tani, nuk guxoi kush ta haptë këtë fushatë. Vetëm z. Prefekt, i cili i njëjshëm mirë Korçën dhe korçarët, vendosi ta ngrehë prefekturën, vendosi ta lërë dhe këtë kujtim të madh në qytetin që aq vjetër qeverisi. Po ku? Në ç'vënd të qytetit do të ngrihet pallati madhështor i prefekturës? Këtu qëndron halli, këtu vërtitet gjithë tema e grindjes, gjithë biseda e përditëshme. Prefekti hesht, se ai e di vetë, ai sheh larg dhe para se ta fillonte këtë fushatë, ai i kish menduar të gjitha.

Mirëpo Korça është ndarë në dy ballë dhe pret me padurim që të ven-

Korça është ndarë në dy ballë dhe pret me padurim që të vendoset vendi i përshtatshëm për ngrirjen e godinës së re. Cilën anë do të kënaqë prefekti? Vallë a do të mund të gjejë një zgjidhje të pëlqyeshme për të dy anët?



doset vendi i përshtatshëm për ngrirjen e godinës së re. Cilën anë do të kënaqë prefekti? Vallë a do të mund të gjejë një zgjidhje të pëlqyeshme për të dy anët? Nuk është shumë zor, po as dhe shumë kollaj. Se që të dy palët e kanë marrë me inat punën, dhe nëse ngritja do të vendoset në bulevard, ose afër Bankës, ose në zemrën e Korçës, pjesa tjetër nuk do të durojë dot. Do të thotë se lagjja e tyre ka vdekur, se lagjja e tyre përtej lumit kërkon të zhvillohet. Dhe mënyra më e mirë dhe më e lehtë është ngritja e godinës të "hyqymeti i vjetër", domethënë afër burgut. Dhe parashtrojnë shumë arsye të tjera, midis të cilave thonë se vendi ku do të ngrihet prefektura është vend qeveritar, kështu që shpëtohen shpenzimet për blerjen e një vendi tjetër.

Thonë se aty kish qënë edhe në kohrat e vjetra. Thonë se po s'u ngrit dot atje prefektura, ajo lagje e madhe është e destinuar të vdesë. Ngulin këmbë se kanë edhe njerëz që interesohen me gjithë shpirt. Se sheh aty afër disa tregtarë të vegjël që janë mbytur në borxhe, i sheh të nënshk-

ruajnë dhe të paguajnë për ndihma friari 200 e 300. Ku i kanë gjetur, ata e dinë. Pjesa tjetër, që është pothuajse gjithë Korça këtej lumit, insiston me këmbëngulje që godina duhet të ngrihet medoemos ja në "Zemrën e Korçës", ja afër bankës, ja kudo gjetke.

Veç te burgu ose në Tavor të mos ngrihet, se atje përveç që.

ringjallen disa (ngjarje) të shkuara, atje përveç që është një vend i papërshtatshëm fare për një godinë kolosale, atje përveç që tregu, pjaca dhe lëvizja janë larg, por s'mund të ngrihet atje, se thonë që vendi i afërmë është i bejlerëve me fuqi, të cilët nuk duhet të bëjnë ç'të dëshirojnë ata sot që jemi të lirë në një monarki demokratike. Shumica duhet të fitojë, thonë, dhe prefektura duhet të ngrihet atje ku meriton.

Nuk mund të përçahet Korça tani për interesat e dy ose tre personave. Dhe kjo, thonë me zemërim, ngjet se dalin në mes njerëz ngatrestarë, njerëz me fuqi, që shikojnë vetëm interesat e tyre personale. (Botuar në vitin 1936)




Nga Petro MARKO



SHKODRA

104 VJET MË PARË



Në vitin 1913, Auguste Leon dhe Jean Bunhes, njëri fotograf e kimist dhe i dyti një profesor i gjeografisë humane në College de France, erdhën në Ballkan për të fotografuar jetën, zakonet dhe njerëzit, zhdukja e të cilëve ishte vetëm "çështje kohe". Ishte e pamundur që ky udhëtim të mos kalonte nëpër Shkodër, një prej qyteteve më të bukura dhe me më shumë histori në mbarë shqiptarinë. Leon dhe Bunhes nisën me njerëzit e Shkodrës, vazhduan me peizazhin dhe me zakonet, me bukurinë e natyrës dhe me atë që shkodranët e quajnë jetë, atëherë në vitin e largët 1913-të, transmeton KultPlus. Fotografitë po realizoheshin për t'iu dërguar më pas Albert Kahn, bankier dhe filantropist francez i cili ruajti rreth 72 mijë fotografi me ngjyra në rreth 22 jete të mbledhjes së fotografive.





Qëndrimet krejtësisht të kundërta të partnerëve të koalicionit qeverisës në Kosovë, lidhur me çështjen e Marrëveshjes për shënjimin e vijës kufitare me Malin e Zi, rrezikojnë qëndrueshmërinë e Qeverisë së Kosovës, të cilën e udhëheqë kryeministri Ramush Haradinaj, vlerësojnë njohësit e zhvillimeve politike në vend

DEMARKACIONI RREZIKON HARADINAJN



min që në rast se Qeveria e kryeministrit Haradinaj nuk e tejkalon problemin e Demarkacionit me Malin e Zi, do ta ketë problem të madh moral që të vazhdojë qeverisjen. "Një gjë duhet të jetë e qartë që çështja e Demarkacionit nuk mund të mbetet pezull. Pra, duhet të ketë zgjidhje apo alternativa. Nuk guxon Qeveria Haradinaj që të thotë 'ne jemi kundër këtij formati të Demarkacionit'. Qeveria Haradinaj do të ketë probleme të mëdha edhe brenda koalicionit (qeverisës), por edhe në raport me partnerët ndërkombëtarë, që ta arsyetojë vazhdimësinë e saj, nëse nuk ka ide se si të ballafaqohet me problemin e Demarkacionit". Në anën tjetër, vet kryeministri Haradinaj ka thënë ditë më parë se vota e tij do të jetë kundër ratifikimit të Marrëveshjes për demarkacionin me Malin e Zi. Dallimet rreth kësaj çështje, kanë vazhduar edhe të martën. Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, lider i Partisë Demokratike të Kosovës, ka thënë se çështja e kufirit me Malin e Zi, duhet të përfundojë. "Lërimi ato pallavra me maja të kodrave, të cilat janë... nuk dua të ndalem më aty. Jemi duke e dëmtuar një krijesë, e cila është shtet i pavarur dhe sovran, siç është Republika


Qeveria e Kosovës tashmë e ka proceduar për në Kuvendin e Kosovës, Projektligjin për ratifikimin e Demarkacionit të kufirit me Malin e Zi, bashkë me të gjeturat e Komisionit Shtetëror për Shënjimin e Kufirit, përbërja e re e të cilit është emëruar nga Qeveria e kryeministrit Haradinaj, me në krye Shpëtim Bulliqin, pas shkarkimit të përbërjes së vjetër, të cilën e drejtonte Murat Meha

e Kosovës", ka thënë Veseli. Por, shefi i grupit parlamentar i Nismës për Kosovën, Sherif Bilalli, ka theksuar se deputetët e këtij subjekti politik, brenda koalicionit qeverisës, do të jenë kundër ratifikimit të marrëveshjes. "Kanë qenë kundër Demarkacionit dhe vazhdojnë të jenë kundër këtij versioni. Nuk është fundi i botës", ka thënë Sherifi. Politologu Tahiri, vlerëson se Qeveria aktuale e vendit është në krizë, të cilën nuk do të mund ta kalojë. "Debatet e ardhshme në Kuvend do të jenë shkak që njëri partner i koalicionit ta lëshojë koalicionin dhe vendi të

shkojë në zgjedhje të parakohshme. Unë pres që pas shqyrtimit të Demarkacionit, në cilindo variant, kaloj ose jo, do të jetë në rend të ditës votëbesimi i Qeverisë", thekson Tahiri. Analisti Muhaxhiri vlerëson që partnerët e koalicionit qeverisës kanë gabuar, që në fillim të arritjes së marrëveshjes së tyre, që nuk e kanë pasur një ide për daljen nga nyja që ka krijuar çështja e Demarkacionit. "Ky ka qenë një gabim i madh i tre liderëve, të PDK-së, AAK-së dhe Nismës, të cilët e kanë krijuar një koalicion qeverisës pa pasur vizion sesi ta zgjidhin problemin kryesor, i cili është si një lloj 'pyke' që në çdo moment mund ta çajë koalicionin qeverisës. Këtu ka qenë lëshimi dhe më nuk ka më asnjë arsytim, sepse duhet të japin zgjidhje", tha Muhaxhiri. Qeveria e Kosovës tashmë e ka proceduar për në Kuvendin e Kosovës, Projektligjin për ratifikimin e Demarkacionit të kufirit me Malin e Zi, bashkë me të gjeturat e Komisionit Shtetëror për Shënjimin e Kufirit, përbërja e re e të cilit është emëruar nga Qeveria e kryeministrit Haradinaj, me në krye Shpëtim Bulliqin, pas shkarkimit të përbërjes së vjetër, të cilën e drejtonte Murat Meha.

Arrestohen në Turqi çifti shqiptar, dyshohet se ishin pjesë e gülenistëve!

32 vjeçari nga Cërriku i Shqipërisë, Mariglen Debrova dhe bashkëshortja e tij njoftohet se janë vënë në pranga para disa ditësh në Ankara. Lajmi ka tronditur familjarët e tij në Cërrik, të cilët janë të shqetësuar për çiftin dhe fëmijën e tyre. Mariglen Debrova jetonte prej 10 vitesh, së bashku me familjen e tij të re në Ankara. Burime të besueshme bëjnë me dije se 32-vjeçari po vazhonte doktoraturën për teologji në qytetin Samsun, pranë Ankarasë në Turqi. Ai ka mbaruar studimet në Egjipt dhe është transferuar në Turqi, ku jetonte me familjen e tij prej shumë vitesh. Të njëjtat burime tregojnë se profesori është arrestuar nën akuzën si bashkëpunëtor i Gülenit, por kjo mbetet për t'u provuar.



Lajmi i rremë krijon "ushtrinë paramilitare" në Bosnjë

Një klub i paintball-it - një lojë sportive që shfrytëzon topa me ngjyra dhe uniforma për të simuluar beteja - në Bosnjë dhe Hercegovinë, ka njoftuar se do ta padisë një rrjet televiziv, pas raportimeve se klubi është një njësi paramilitare që po formohet jashtëligjshëm nga anëtarët i Presidencës së vendit, Bakir Izetbegović. Përplasja filloi kur gazeta nga Beogradi, Večernje Novosti, raportoi më 25 nëntor se Izetbegović ka trajnuar jashtëligjshëm më shumë se 9 mijë boshnjakë. Televizioni ATV në Banja Llukë, që ndodhet në Republikën Srpska, ka shkuar edhe një hap më larg, duke shfaqur fotografi të milicisë, për të cilat ka thënë se i ka siguruar në mënyrë ekskluzive. Fotografitë shfaqin disa burra të veshur me rroba ushtarake dhe duke mbajtur armë - për të cilat klubi thotë se janë armë ajri, që hedhin topa të butë të mbushur me ngjyrë. Klubi "Crnja Munja", ose "Vetëtimia e



Zeze", i ka cilësuar raportimet si 'gënjeshtër të neveritshme dhe trillime' që janë bërë nga ana e mediave, pa ndonjë tentativë për të verifikuar vërtetësinë e lajmit. "Për këtë arsye, dhe për faktin se klubi jonë është më i madhi dhe më i famshmi në Bosnjë dhe Hercegovinë, ne besojmë që gazetarët nga ky televizion nuk e kanë publikuar rastësisht artikullin kundërthënës, por se prapa gjithë këtij rrëfimi qëndrojnë faktorë të tjerë, që kanë për qëllim krijimin e

Përplasja filloi kur gazeta nga Beogradi, Večernje Novosti, raportoi më 25 nëntor se Izetbegović ka trajnuar jashtëligjshëm më shumë se 9 mijë boshnjakë. Televizioni ATV në Banja Llukë, që ndodhet në Republikën Srpska, ka shkuar edhe një hap më larg, duke shfaqur fotografi të milicisë, për të cilat ka thënë se i ka siguruar në mënyrë ekskluzive

frikës e panikut te qytetarët e Bosnjës dhe Hercegovinës", ka thënë ky klub në një njoftim për medie. "Klubi tashmë e ka raportuar televizionin e përmendur tek Agjencia e Rregullatorit të Komunikimeve të Bosnjës, të cilët i kemi njoftuar për materialin kundërthënës. Ne nuk do të ndalem vetëm me kaq, dhe po përgatisim një padi gjithëpërfshirëse, për shpifje dhe dëmtim të reputacionit, dhe shkaktim të dëmit ekonomik për klubin tonë", thuhet tutje në njoftim.

Bosnja ka qenë e dëmtuar nga tensionet e brendshme në mes të boshnjakëve - popullsisë myslimane boshnjake - kroateve dhe serbëve. Ky vend ka qenë pjesë e Jugosllavisë deri në shpërbërjen e shtetit komunist në fillimin e viteve 1990, dhe ka shpallur pavarësinë në mars të vitit 1992, duke shkaktuar një luftë civile në mes të popullsisë myslimane, kroate e serbe. Lufta, që përfundoi pas in-

tervenimit ndërkombëtar në dhjetor të vitit 1995, shkaktoi vdekjen e rreth 100 mijë njerëzve dhe zhvendosjen e rreth 2.6 milionë të tjerëve.

Në raport, televizioni ATV e ka pyetur Izetbegovićin nëse ai është duke formuar një njësi paramilitare, por ai nuk e konfirmon dhe as a mohon një gjë të tillë, duke thënë se "asnjëherë nuk do të ketë problem nga ne".

Agjencia Shtetërore e Hetimit dhe e Mbrojtjes e Bosnjës e Hercegovinës ka thënë se nuk ka "njohuri rreth formimit të milicive paralele/sekrete në vend, që pretendohet se po koordinohen nga një anëtar i Presidencës boshnjake". Bazuar në faqen e Facebook-ut, Klubi është një "organizatë joprofitabile, joqeveritare, që e promovon paintball-in si sport". Që nga përfundimi i luftës në vitin 1995, Bosnja është ndarë në dy entitete - Republika Srpska dhe Federata kroate-myslimane.

PROFESIONET E LIDERËVE EVROPIANË

ZJARRFIKËS, FILOZOF, HISTORIAN DHE PA DIPLOMË FARE

Sipas gazetarit që ka bashkuar të dhënat, më interesante e bën faktin se kryeministri i Bullgarisë, Bojko Borisov ka studiuar për zjarrfikës. Duke vëzhguar në të gjithë fushat e studimit të liderëve evropianë, vihet re, sipas tij, në fushën e artit dhe shkencave sociale janë veçse 4 shtete, ndër të cilat Shqipëria, me diplomën "Artet e Bukura", Franca me "Filozofi", Holanda me "Histori"



Duket se, pak a shumë, çdo lloj diplome do të të ndihmojë që të ecësh në korridoret e pushtetit politik të Evropës. Një hartë e përpiluar së fundmi nga platforma Reddit, me të dhënat e ofruara nga gazetari Pádraig Belton, vizualizon Evropën me ngjyra dhe profesione sipas diplomës së parë të studimit të secilit nga kryesuesit të shtetit. Harta flet për një shumëllojshmëri fushash studimi, ku madje vihet re edhe mungesa e një diplome, në rastin e kryeministrit të Suedisë, Stefan Lofven. Megjithatë harta tregon një përzierje të fushave të arteve dhe degëve shkencore, rëndësia e dukshme e ligjit e bën atë shumë më pak interesante. Sipas gazetarit që ka ba-

shkuar të dhënat, më interesante e bën faktin se kryeministri i Bullgarisë, Bojko Borisov ka studiuar për zjarrfikës. Duke vëzhguar në të gjithë fushat e studimit të liderëve evropianë, vihet re, sipas tij, në fushën e artit dhe shkencave sociale janë veçse 4 shtete, ndër të cilat Shqipëria, me diplomën "Artet e Bukura", Franca me "Filozofi", Holanda me "Histori". Në këtë hartë dominon diploma në fushën e ligjit, përkatësisht 14 shtete, pjesa më e madhe e të cilave të Evropës qendrore, por edhe dy shtetet e gadishullit Iberik. Në kundërsht të plotë me diplomën, që në rang botëror ka shpërndarjen më të madhe, ajo e biznesit, duket se liderët evropianë janë më tepër të fushës së



Harta flet për një shumëllojshmëri fushash studimi, ku madje vihet re edhe mungesa e një diplome, në rastin e kryeministrit të Suedisë, Stefan Lofven



shkencave humane. Liderë të tjerë sakaq sipas hartës, kanë studiuar për sociologji, marrëdhënie ndërkombëtare, gazetari, sociologji. Vetëm lideri italian ka studiuar për Shkencat Politike. Një studim nga DDI, një kompani konsulence globale, bëri një zbulim të habitshëm: Të diplomuarit në shkencat humane performojnë më mirë si liderë, se sa atë me një diplomë MBA në një numër fushash thelbësore. Sikurse tregohet nga analiza e DDI, të qenit lider i mirë, i ka rrënjët në të qenit një folës i suksesshëm. Përtej aftësive ndërpersonale, ata me diploma në shkencat humane kanë aftësi më të forta sipërmarrëse dhe janë më të orientuar drejt rezultateve.

SHBA-të çojnë ambasadën në Jerusalem

Shtetet e Bashkuara të Amerikës do të zhvendosin ambasadën e tyre në Izrael nga Tel Avivi në Jerusalem pas 6 muajsh, duke njohur kështu Jerusalem si kryeqytetin e Izraelit. Ka qenë vetë presidenti amerikan Donald Trump që ia ka komunikuar lajmin homologut të tij palestinez Abu Mazen, përmes një telefonate. Vendimi i Trump cilësohet si shantazh dhe rrezik për paqen nga presidenti palestinez. Autoritetet në Palestinë njoftuan 3 ditë më parë ndaj Washingtonit, që do të shoqërohen me protesta në vend dhe u bënë thirrje të gjithë qytetarëve të tyre në Izrael e kudo në botë të mbledhen pranë ambasadave të Izraelit për të shprehur zemërimin e përgjithshëm ndaj këtij vendimi. Tensioni mbetet i lartë pas vendimit të Washingtonit për të zhvendosur ambasadën. Presidenti francez Macron u shpreh i shqetësuar për vendimin e Trump, Mbreti i Arabisë Saudite Salman e quajti një hap të rrezikshëm që do të irritojë myslimanët në mbarë botën. Më herët presidenti turk Rexhep Taip Erdoan lëshoi një paralajmërim të ashpër ndaj homologut të tij amerikan. Nëse kjo ndodh, Turqia do të ndërprejë marrëdhëniet diplomatike me Izraelin, tha Erdoan, i cili e cilësoi Jerusalem vijë të kuqe për myslimanët. Jerusalem konsiderohet qytet i shenjtë si për hebrenjtë ashtu edhe për myslimanët. Mollë shërri është aktualisht pjesa lindore e populluar nga arabët, të cilën izraelitët e kanë nën kontroll prej 1967-ës. Palestinezët kërkojnë që ajo zonë të jetë kryeqytet i shtetit të tyre të pavarur. Ndërsa izraelitët pretendojnë se i gjithë qyteti është pjesë e kombit të tyre dhe se prej 3 mijë vjetësh është kryeqyteti i Izraelit.

Në mes të Gjermanisë pa drita dhe ngrohje

Vitin e kaluar në Gjermani u është ndërprerë rryma elektrike 328.000 familjeve sepse ato nuk kishin paguar faturat. Po ashtu 6.6 milionë familje kanë marrë paralajmërim për ndërprerjen e energjisë elektrike po për këtë shkak



Sipas të dhënave të Agjencisë Gjermane për Energjinë vitin e kaluar në Gjermani u është ndërprerë rryma elektrike 328.000 familjeve sepse ato nuk kishin paguar faturat. Po ashtu 6.6 milionë familje kanë marrë paralajmërim për ndër-

prerjen e energjisë elektrike po për këtë shkak. Ndërprerja e rrymës bëhet kur dikush i ka borxh kompanisë së furnizimit me energji elektrike 100 euro dhe pasi është paralajmëruar disa herë. Atij që i pritret rryma elektrike është i dety-

ruar të paguajë jo vetëm shumën e prapambetur, por edhe shpenzimet për rilidhjen e rrymës elektrike që mund të shkojnë deri në 200 euro. Për shumë persona që jetojnë me ndihmë sociale apo kanë të ardhura të ulëta në Gjermani, këto shpenzime janë të vështira për t'u përballuar. Sipas një studimi të Caritasit gjerman, prej paralajmërimeve për prerjen e dritave janë të prekura më tepër familjet, kurse prej prerjes së dritave për shkak mospagese personat që jetojnë vetëm. Ajo që bie po ashtu në sy është se ndër personat më tepër të prekur bëjnë pjesë personat me nivel të ulët shkollimi që nuk i kuptojnë mirë shkresat dhe ligjet dhe nuk dinë të komunikojnë

me autoritetet. Po ashtu, shumë prej tyre kanë edhe borxhe, sepse shpenzojnë më tepër se sa kanë të ardhura. Autoritetet e studimit rekomandojnë që të organizohen kurse për t'u mësuar njerëzve se si të jetojnë me pak të ardhura dhe si të mos shpenzojnë më tepër se sa fitojnë. Po ashtu kërkohet që për ata që marrin ndihmë sociale të bëhen më tepër sqarime që të mos shkojnë puna deri tek ndërprerja e energjisë elektrike. Shumë kërkojnë edhe ngritjen e ndihmës sociale për shkak të rritjes së shpenzimeve dhe të çmimeve. Por edhe shtimin e përdorimit të aparateve elektrike, si frigoriferit etj., që harxhojnë pak energji.

REPUBLIKA E MAQEDONISË
MINISTRA PËR PUNË DHE POLITIKË SOCIALE
Shpall

Kërkesë për shprehjen e interesit për

Revizionin e realizuar të shtëpive të pensionistëve në Maqedoni
(nr. ref. MK/UPN # 2.1.72)

Emri i projektit: Projekt për kompensime të kushtëzuara në të holla (UNP Projekt)

Kredia Nr # 7735 - MK

Shërbime konsultative – Kompani konsultuese

Kjo thirrje për shprehje të interesit është në pajtueshmëri me njoftimin e përgjithshëm të furnizimit të UPN projektit, e publikuar në „UN Development Business”, në version elektronik më 17.12.2009 si dhe në formë të shtypur më 16.01.2010 (Numri i botimit: 776).

Republikës së Maqedonisë, Banka Botërore ia ka miratuar kredinë për nevojat e realizimit të Projektit për kompensim të kushtëzuar në të holla. Pjesë e këtyre mjeteve do të shfrytëzohen për pagesën e obligimeve që do të dalin nga marrëveshja nr: MK/UPN # 2.1.72 që do të arrihet me kompani e cila do të duhet të kryejë revision të ndërtuar të shtëpive të pensionistëve në Maqedoni.

Kushtet konsultative përfshijnë: vlerësim të efikasitetit të masave, politikat dhe aktivitetet e marra për plotësimin e të drejtave dhe mbrojtjes sociale të personave të moshuar në drejtim të vendosjes së tyre nëpër shtëpitë shtetërore të pensionistëve dhe rekomandime për përparimin e menaxhimit të shtëpive të pleqve, përparimin e standardeve për vendosje, rritjen e të hyrave, uljen e harxhimeve vijuese etj.

Përshkrimi i përgjithshëm i detyrave projektuese është publikuar në ueb faqen e Ministrisë: www.mtsp.gov.mk.

Kompania duhet ti posedojë këto kualifikime (kriteret për selektim të kompanive në listë të shkurtër):

- Konsulent në pesë vitet e fundit duhet të ketë realizuar së paku një aktivitet që është i ngjashëm me aktivitetin që është lëndë e këtij furnizimi (titulli i aktivitetit, përshkrim, kohëzgjatje, vlera e marrëveshjes, vërtetim për realizimin e marrëveshjes),
- Të ketë përvojë në kryerjen e performancës dhe analizës financiare të institucioneve publike,
- Përvojë me buxhetim, menaxhmet financiar dhe pagesor.

Ministria e punës dhe politikës sociale fton gjithë kompanitë e interesuara (konsulentë) të shprehin interes për këtë angazhim. Kompanitë e interesuara duhet të plasojnë informata me të cilat do të dëshmojnë se kanë kualifikimet e duhura dhe përvojë për kryerjen e shërbimit të kërkuar (portofol të firmës, broshura, përshkrim të projekteve të ngjashme, kuadër me kualifikime të nevojshme etj). Biografite e shkurtra të ekipit të propozuar dhe ekspertëve nga a e kompanive nuk do të jenë lëndë për ovulim të kësaj faze të përzgjedhjes së kompanisë në listë të shkurtër.

Kompanitë konsultative mundet të aplikojnë bashkërisht me qëllim që ti risin kualifikimet e tyre. “Bashkimi”, mund të jetë në formë të investimit të përbashkët (Joint

Venture) ose në formë të nën-kontraktues. Në rast të investimit të përbashkët, pos vendosjes së listës të shkurtër të konsulentëve të kualifikuar, kualifikimi i të gjithë partnerëve do të vlerësohet bashkërisht dhe gjithë partnerët e investimit bashkërisht dhe individualisht do të përgjigjen për realizimin e marrëveshjes, i cili do të nënshkruhet nga të gjithë partnerët e investimit të përbashkët. Konsulentët e interesuar në aplikacion qartë duhet të theksojnë për llojin e bashkimit të tyre dhe obligimeve të partnerëve nën-kontraktues. Aplikacionet e pa qarta – shprehjet në interes të llojit “në bashkëpunim me”, ose/apo “të lidhur me” dhe të tjera, mund të mos merren parasysh gjatë vendosjes së listës së shkurtër. Duke u nisur nga principi një shprehje në interes të kompanisë, kompanitë konsultative mund të zgjedhin a do të aplikojnë si nën-kontraktues, si konsulentit individual ose si partner të investimit të përbashkët. Ju lusim të keni parasysh se në furnizim të njëjtë një kompani mund të parashtroj vetëm një shprehje në interes qoftë ajo si konsulent individual po si partner për investim të përbashkët. Një kompani nuk mund nën-kontraktuese dhe të shfaqet individualisht ose si partner në investim të përbashkët në të njëjtin furnizim. Ne qoftë se kompania shfaqet si nën-kontraktues të konsulentit individual ose të investimit të përbashkët, e njëjta mund të jetë nën-kontraktues në më shumë se një aplikues.

Përzgjedhja do të bëhet në pajtueshmëri me procedurat e Bankës Botërore në Udhëzimet të Bankës Botërore për përzgjedhje të shfrytëzuesve konsultues (huamarrës) nga Banka Botërore, nga Maj 2014, reviduar në tetor 2006, në disponim në ueb faqen www.worldbank.org. Metoda për furnizim është “Përzgjedhje e bazuar në kualifikimet e konsultuesit”.

Për më tepër informacione mund të drejtoheni në Njësinë për menaxhim me Projektin KMK, nga ora 8 e 30 deri në orën 16 e 30 në e-mail: sanja.andovska@mtsp.gov.mk.

Shprehjet e interesit mund të dorëzohen në mënyrë elektronike në adresën elektronike: sanja.andovska@mtsp.gov.mk ose në postë me adresën: Ministria e Punës dhe Politikës Sociale, Projekti për Kompensim të mjeteve të kushtëzuara (Projekt UPN), Dame Gruev 14, 1000 Shkup, Republika e Maqedonisë, me mbishkrimin: Për Jasmina Jovanovska, Drejtore e Projektit UPN) (ref.nr. 2.1.71)

Dokumentet me të cilat shfaqet interesi (duhet të jenë maqedonisht ose anglisht) dhe duhet të dorëzohen më së voni deri 13.12.2017.

REPUBLIKA E MAQEDONISË
MINISTRIA E PUNËS DHE POLITIKË SOCIALE
Shpall

Kërkesë për shprehje të interesit për

realizim të revizionit Operativ për Programin për kompensim të kushtëzuar në të holla për arsim të mesëm dhe të Programit për kompensim të kushtëzuar në të holla për punësime të subvencionuara
(ref.nr. MK/UPN # 2.3.5)

Emri i projektit: Projekt për kompensim të kushtëzuar në të holla (UPN Projekt),

Kredit Nr: 7735-MK

Shërbime konsultative- Kompani konsultative

Republikës së Maqedonisë i është miratuar kredi nga ana e Bankës ndërkombëtare për rindërtim dhe zhvillim për nevojat e realizimit të Projektit për kompensim të kushtëzuar në të holla (UPN). Një pjesë e këtyre mjeteve do të shfrytëzohen për realizim të Revizionit operativ të Programit për kompensim të kushtëzuar në të holla për arsimin e mesëm dhe të Programit të kushtëzuar në të holla për subvencionim të punësimit.

Qëllimi kryesor i kësaj detyrë është vërtetimi se vallë dy programet UPN, të cilat zbatohen nga ana e Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale (MPPS), e.q. Programi për kompensim të kushtëzuar në të holla për arsimin e mesëm (për vitin 2016/2017 dhe 2017/2018) dhe Programin për kompensim të kushtëzuar në të holla për subvencionim të punësimit (për vitin 2017 dhe 2018) janë duke u zbatuar në pajtim me udhëzimet e dhëna në Doracakun për administrim të programit për kompensim të kushtëzuar në të holla dhe Doracakut operativ për programin e subvencionimit të punësimit, evoluimi i efikasitetit të proceseve të definuara dhe dhënia e rekomandimeve për aftësim/modifikim të procesit me doracakët e theksuar.

Përshkrimi i plotë i detyrave projektuese është publikuar në adresën elektronike të Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale: www.mtsp.gov.mk

Kriteret për selektim të kompanive në lista të shkurta:

- Minimum 3 vite përvojë në realizimin e hulumtimeve, analizave kuantitative dhe kualitative, dhe evoluimin e proceseve të kapshëm për programet e mbrojtjes sociale, arsimit dhe punësimit;

Përvojë në realizimin e analizave tek institucionet publike;

Vëllime të mjaftueshme të hulumtimeve të realizuara kuantitative dhe kualitative;

- Njohje e shkëlqyeshme e metodologjisë së hulumtimeve. Projektet e publikuara hulumtuese do të merren parasysh si përparësi;
- Përvojë në zbatimin e analizave të programeve nga sektori publik, përfshi përvojat në ndërtimin e kapaciteteve të institucioneve nga sektori publik;

Ministria e Punës dhe Politikës Sociale ju bën thirrje të gjitha kompanive të interesuara (konsultative) të shprehin interes për këtë angazhim. Kompanitë e interesuara duhet të dorëzojnë informacione me të cilat tregohet se posedojnë përvojë dhe kualifikime për përmbushjen e shërbimeve të kërkuara (portofol i kompanisë, broshura, përshkrime të projekteve të ngjashme, kuadër me kualifikimet e kërkuara etj). Biografi të shkurtra nga ekipi i propozuar i ekspertëve nga ana e kompanive nuk do të jenë lëndë e evoluimit në këtë fazë të përzgjedhjes së kompanive në lista të shkurta.

Kompanitë konsultative mundet të aplikojnë të bashkuar me qëllim rritjen e kualifikimeve të tyre. “Bashkimi” mundet të jetë në formë të investimit të përbashkët (Joint Venture) apo në formë të nën-negociatorit. Në rast të investimit të përbashkët, gjatë vendosjes së listës së shkurtër të konsulentëve të kualifikuar, të gjithë kualifikimet e partnerëve do të evoluohet bashkërisht dhe të gjithë partnerët në investimin e përbashkët dhe atë individuale do të përgjigjen për realizimin e marrëveshjes, e cila do të nënshkruhet nga të gjithë partnerët e investimit të përbashkët.

Konsulentët e interesuar në aplikacion duhet qartë të nënvizojnë llojin e bashkimit të tyre dhe obligimet e partnerëve dhe nën negociatorëve. Aplikacionet e paqarta, shprehjet e interes, të llojit “në bashkëpunim me” ose/apo “të lidhur me” etj, mundet të mos merren parasysh gjatë vendosjes së listës së shkurtër. Nisur nga parimi një shprehje të interesit nga një kompani, kompanitë konsultative mundet të zgjedhin a do të aplikojnë si nën negociator, si konsulent individual apo si partner në investim të përbashkët.

Ju lutemi të keni parasysh në procedurën e furnizimit, një kompani mundet të dorëzon vetëm një shprehje të interesit, qoftë si konsulent individual apo si partner në investim të përbashkët. Një kompani nuk mundet të jetë nën negociator dhe të merr pjesë individualisht apo si partner në investim të përbashkët në procedurën e furnizimit.

Në rast se kompania merr pjesë si nën negociator të konsulentit individual apo si investim i përbashkët, e njëjta mundet të jetë nën negociator e më shumë aplikuesve.

Përzgjedhja do të bëhet në pajtim me procedurat e Bankës Botërore të dhëna në Udhëzimin e Bankës Botërore për përzgjedhje dhe punësim të konsulentëve nga shfrytëzuesit (huamarrësi) i Bankës Botërore, nga maji i vitit 2004, i reviduar në tetor të vitit 2006, e cila është në dispozicion në adresën elektronike www.worldbank.org. Metoda e furnizimit është “Përzgjedhje e bazuar në kualifikimet e konsulentëve”

Për informacione plotësuese mundet të drejtoheni në Njësinë për menaxhim me UPN Projektin, nga ora 08.30 deri në 16.30, në e-mail: sanja.andovska@mtsp.gov.mk

Shprehjet e interesit mundet të dorëzohen përmes postës elektronike në adresat në vijim: sanja.andovska@mtsp.gov.mk ose përmes postës në adresën përkatëse: Ministria e Punës dhe Politikës Sociale, Projekt për kompensim e kushtëzuar në të holla (UPN Projekt), Dame Gruev 14, 1000 Shkup, Republika e Maqedonisë.

Me titull: për Jasmina Jovanovsak, Drejtore e KKP projektit (ref.nr. 2.3.5)

Dokumentet me të cilat shprehet interesi (në gjuhën maqedone dhe angleze) më së voni të dorëzohen deri më 13.12.2017

REPUBLIKA E MAQEDONISË
MINISTRIA E PUNËS DHE POLITIKËS SOCIALE

Shpall

Kërkesë për shprehje të interesit për realizim të Revizionit realizues të Programit për kompensim të kushtëzuar në të holla për arsim të mesëm dhe të Programit për kompensim të kushtëzuar në të holla për punësim i subvencionuar (nr. ref. MK/UPN # 2.3.6)

Emri i projektit: Projekt për kompensime të kushtëzuara në të holla (UPN Projekt)

Nr. kredisë: 7735 –MK

Shërbime konsulente – Kompania konsulente

Republikës së Maqedonisë i është lejuar kredi nga ana e Bankës ndërkombëtare për renovim dhe zhvillim për nevojat e realizimit të Projektit për kompensim të kushtëzuar në të holla (UPN). Një pjesë e këtyre mjeteve do të shfrytëzohen për realizim të Revizionit realizues të Programit për kompensim të kushtëzuar në të holla për arsim të mesëm (për vitin shkollor 2016/2017 dhe 2017/2018) dhe të Programit për kompensim të kushtëzuar në të holla për punësim të subvencionuar (për vitin 2017 dhe 2018).

Kushtet të cilat janë lëndë e furnizimit me këtë thirrje përfshijnë revizion/vlerësim të realizimit të procesit për përcjellje të përbushjes së kushteve dhe të procesit të pagesës së kompensimeve të kushtëzuara në të holla, në kuadër të të dyja UPN programeve, të cilat implementohen nga ana e Ministrisë së punës dhe politikës sociale (MPPS). Në lidhje me procesin për përcjellje të përbushjes së kushteve, qëllimi kryesor i kësaj detyre është kontrollimi i informatave të marra nga UPN programi në lidhje me gjendjen reale të aplikuesve, të dhënat nga sistemet e informacionit të MPPS dhe nga Agjencia për punësim e RM (APRM) dhe të informacioneve të përmbajtura në ditarët e shkollave (në lidhje me realizimin e UPN programit për arsim të mesëm). Në lidhje me procesin e pagesës, qëllimi kryesor i kësaj detyre është përmes kontrollimit të terrenit të vërtetohet saktësia e informatave të marra nga programi dhe nga sistemet e informacionit të MPPS dhe APRM me pagesat reale të shfrytëzuesve përfundimtar.

Përshkrimi i tërësishëm i detyrave projektuese është dhënë në ueb faqen e Ministrisë së punës dhe politikës sociale: www.mtsp.gov.mk.

Kriteret për selektim të kompanive në listë të shkurtër:

- Së paku 3 vjet përvojë në realizimin e hulumtimeve dhe analizave kuantitative dhe kualitative;
- Vëllim të konsiderueshëm të hulumtimeve të realizuara kualitative dhe kuantitative;
- Njohje të shkëlqyeshme të metodologjisë së hulumtimeve;
- Hulumtime në sferën e mbrojtjes sociale, arsimit dhe punësimit do të konsiderohet si përparësi;
- Përvojë të rëndësishme dhe kapacitet në sferën e planifikimit dhe logjistikës për realizim të anketave;
- Rrjet të zhvilluar të regjistruarve, mbikëqyrësve dhe shënuesve të informatave me përvojë;
- Kapacitet për menaxhim me të dhënat dhe statistikë;
- Përvojë në punë me: SPSS, CS-Pro ose Stata.

Ministria e punës dhe politikës sociale fton gjithë kompanitë e interesuara (konsulentë) të shprehin interes për këtë angazhim. Kompanitë e interesuara duhet të plasojnë informata me të cilat do të dëshmojnë se kanë kualifikimet e duhura dhe përvojë për kryerjen e shërbimit të kërkuar (portofol të firmës, broshura, përshkrim të projekteve të ngjashme, kuadër me kualifikime të nevojshme etj).

Biografite e shkurtra të ekipit të propozuar dhe ekspertëve nga ana e kompanive nuk do të jenë lëndë për ovulim të kësaj faze të përzgjedhjes së kompanisë në listë të shkurtër.

Kompanitë konsultative mundet të aplikojnë bashkërisht me qëllim që t'i rrisin kualifikimet e tyre. “Bashkimi”, mund të jetë në formë të investimit të përbashkët (Joint Venture) ose në formë të nën-kontraktues. Në rast të investimit të përbashkët, pos vendosjes së listës të shkurtër të konsulentëve të kualifikuar, kualifikimi i të gjithë partnerëve do të vlerësohet bashkërisht dhe gjithë partnerët e investimit bashkërisht dhe individualisht do të përgjigjen për realizimin e marrëveshjes, i cili do të nënshkruhet nga të gjithë partnerët e investimit të përbashkët. Konsulentët e interesuar në aplikacionin duhet të theksojnë për llojin e bashkimit të tyre dhe obligimeve të partnerëve nën-kontraktues. Aplikacionet e pa qarta – shprehjet në interes të llojit “në bashkëpunim me”, ose/apo “të lidhur me” dhe të tjera, mund të mos merren parasysh gjatë vendosjes së listës së shkurtër. Duke u nisur nga principi një shprehje në interes të kompanisë, kompanitë konsultative mund të zgjedhin a do të aplikojnë si nën-kontraktues, si konsulentit individual ose si partner të investimit të përbashkët. Ju lusim të keni parasysh se në furnizim të njëjtë një kompani mund të parashtrij vetëm një shprehje në interes qoftë ajo si konsulent individual po si partner për investim të përbashkët. Një kompani nuk mund nën-kontraktuese dhe të shfaqet individualisht ose si partner në investim të përbashkët në të njëjtin furnizim. Ne qoftë se kompania shfaqet si nën-kontraktues të konsulentit individual ose të investimit të përbashkët, e njëjta mund të jetë nën-kontraktues në më shumë se një aplikues.

Përzgjedhja do të bëhet në pajtueshmëri me procedurat e Bankës Botërore në Udhëzim të Bankës Botërore për përzgjedhje të shfrytëzuesve konsultues (huamarrës) nga Banka Botërore, nga maj 2004, reviduar në tetor 2006, në disponim në ueb faqen www.worldbank.org. Metoda për furnizim është “Përzgjedhje e bazuar në kualifikimet e konsultuesit”.

Për më tepër informacione mund të drejtoheni në Njësinë për menaxhim me Projektin UPN, nga ora 8 e 30 deri në orën 16 e 30 në e-mail: sanja.andovska@mtsp.gov.mk.

Për më tepër informacione mund të drejtoheni në Njësinë për menaxhim me Projektin UPN, nga ora 8 e 30 deri në orën 16 e 30 në e-mail: sanja.andovska@mtsp.gov.mk.

Shprehjet e interesit mund të dorëzohen në mënyrë elektronike në adresën elektronike: sanja.andovska@mtsp.gov.mk ose në postë me adresën: Ministria e Punës dhe Politikës Sociale, Projekti për Kompensim të mjeteve të kushtëzuara (Projekt UPN), Dame Gruev 14, 1000 Shkup, Republika e Maqedonisë, me mbishkrimin: Për Jasmina Jovanovska, Drejtore e Projektit UPN (ref.nr. 2.3.6)

Dokumentet me të cilat shfaqet interesi (duhet të jenë maqedonisht ose anglisht) dhe duhet të dorëzohen më së voni deri 13.12.2017.

REPUBLIKA E MAQEDONISË
MINISTRIA E PUNËS DHE POLITIKËS SOCIALE

Shpallje

Kërkesë për shprehjen e interesit për Vlerësimi i nevojave për përkujdesjen dhe shërbimet për zhvillimin e hershëm të fëmijëve në Maqedoni (nr.ref.MK/UPN # 2.1.69)

Emri i projektit: Projekt i kompensimit të kushtëzuar në të holla (UPN Projekt)

Kredi Nr: 7735 –MK

Shërbime konsultante - Kompani konsultante

Kjo ftesë për shprehjen e interesit është në pajtim me shpalljen e përgjithshme për furnizime të UPN projektit, e publikuar në „UN Development Business” në versionin elektronik të datës 17.12.2009 si dhe në formën e shtypur me datën 16.01.2010 (Numri i botimit: 766).

Republikës së Maqedonisë i është lejuar kredi nga Banka botërore për nevojat e realizimit të Projektit për kompensim të kushtëzuar në të holla. Një pjesë e këtyre mjeteve do të shfrytëzohen për pagesën e obligimeve që do të dalin nga marrëveshja nr. MK/UPN # 2.1.69 do do të lidhet me kompaninë e cila do ta kryej vlerësimin e nevojave për përkujdesjen dhe shërbimet për zhvillimin e hershëm të fëmijëve në Maqedoni.

Shërbimet konsultante përfshijnë: identifikimin e nevojave të komunave për shërbime parashkollore, vlerësimin e kapaciteteve aktuale të vendit për sigurimin e shërbimeve të nevojshme dhe përgatitjen e një propozim plani për komuna për plotësimin e nevojave të identifikuara.

Përshkrimi i plotë i detyrave të projektit është e bashkangjitur në faqen e internetit të Ministrisë: www.mtsp.gov.mk.

Kompania duhet të plotësojë kualifikimet në vijim (kriteret për seleksionim të kompanive të listës së shkurtër):

- Konsultanti në pesë vitet e fundit duhet të ketë të realizuar më së paku një aktivitet që është i ngjashëm me aktivitetin që është lëndë e këtij furnizimi (emri i aktivitetit, përshkrim, kohëzgjatja, vlera e marrëveshjes, vërtetim për marrëveshje të realizuar),
- Të ketë përvojë në zbatimin e hulumtimeve sociologjike,
- Përvojë në punë me institucione shtetërore/ministri relevante dhe komuna rurale/urbane,
- Konsultanti duhet të ketë rrjet të gjerë të grumbulluesve të të dhënave me përvojë, mbikëqyrës dhe regjistruar të të dhënave në numër të cilët do të sigurojnë grumbullimin e të dhënave të përafërsisht 2.400 amvisërive në afat prej tre muaj, në të gjithë territorin e Maqedonisë,
- Përvojë dhe kapacitet të rëndësishëm në fushën e planifikimit dhe logjistikës për zbatimin dhe hulumtimin..

Ministria e punës dhe politikës sociale fton gjithë kompanitë e interesuara (konsulentë) të shprehin interes për këtë angazhim. Kompanitë e interesuara duhet të plasojnë informata me të cilat do të dëshmojnë se kanë kualifikimet e duhura dhe përvojë për kryerjen e shërbimit të kërkuar (portofol të firmës, broshura, përshkrim të projekteve të ngjashme, kuadër me kualifikime të nevojshme etj).

Biografite e shkurtra të ekipit të propozuar dhe ekspertëve nga ana e kompanive nuk do të jenë lëndë për ovulim të kësaj faze të përzgjedhjes së kompanisë në listë të shkurtër.

Kompanitë konsultative mundet të aplikojnë bashkërisht me qëllim që ti rrisin kualifikimet e tyre. “Bashkimi”, mund të jetë në formë të investimit të përbashkët (Joint Venture) ose në formë të nën-kontraktues. Në rast të investimit të përbashkët, pos vendosjes së listës të shkurtër të konsulentëve të kualifikuar, kualifikimi i të gjithë partnerëve do të vlerësohet bashkërisht dhe gjithë partnerët e investimit bashkërisht dhe individualisht do të përgjigjen për realizimin e marrëveshjes, i cili do të nënshkruhet nga të gjithë partnerët e investimit të përbashkët. Konsulentët e interesuar në aplikacionin duhet të theksojnë për llojin e bashkimit të tyre dhe obligimeve të partnerëve nën-kontraktues. Aplikacionet e pa qarta – shprehjet në interes të llojit “në bashkëpunim me”, ose/apo “të lidhur me” dhe të tjera, mund të mos merren parasysh gjatë vendosjes së listës së shkurtër. Duke u nisur nga principi një shprehje në interes të kompanisë, kompanitë konsultative mund të zgjedhin a do të aplikojnë si nën-kontraktues, si konsulentit individual ose si partner të investimit të përbashkët. Ju lusim të keni parasysh se në furnizim të njëjtë një kompani mund të parashtrij vetëm një shprehje në interes qoftë ajo si konsulent individual po si partner për investim të përbashkët. Një kompani nuk mund nën-kontraktuese dhe të shfaqet individualisht ose si partner në investim të përbashkët në të njëjtin furnizim. Ne qoftë se kompania shfaqet si nën-kontraktues të konsulentit individual ose të investimit të përbashkët, e njëjta mund të jetë nën-kontraktues në më shumë se një aplikues.

Përzgjedhja do të bëhet në pajtueshmëri me procedurat e Bankës Botërore në Udhëzim të Bankës Botërore për përzgjedhje të shfrytëzuesve konsultues (huamarrës) nga Banka Botërore, nga Maj 2014, reviduar në tetor 2006, në disponim në ueb faqen www.worldbank.org. Metoda për furnizim është “Përzgjedhje e bazuar në kualifikimet e konsultuesit”.

Për më tepër informacione mund të drejtoheni në Njësinë për menaxhim me Projektin KMK, nga ora 8 e 30 deri në orën 16 e 30 në e-mail: sanja.andovska@mtsp.gov.mk.

Shprehjet e interesit mund të dorëzohen në mënyrë elektronike në adresën elektronike: sanja.andovska@mtsp.gov.mk ose në postë me adresën: Ministria e Punës dhe Politikës Sociale, Projekti për Kompensim të mjeteve të kushtëzuara (Projekt KMK), Dame Gruev 14, 1000 Shkup, Republika e Maqedonisë, me mbishkrimin: Për Jasmina Jovanovska, Drejtore e Projektit KMK (ref.nr. 2.1.69)

Dokumentet me të cilat shfaqet interesi (duhet të jenë maqedonisht ose anglisht) dhe duhet të dorëzohen më së voni deri 13.12.2017.

Në bazë të nenit 6 paragrafi 1 pikës 2 dhe nenit 7 paragrafi 1 alinesë 8 të Ligjit të Byrosë së zhvillimit të arsimit („Gazeta Zyrtare e R. së Maqedonisë“ nr. 37/2006, 142/2008, 148/2009, 69/13, 120/13, 148/13, 41/14 dhe 30/16), neni 3 paragrafi 1 alineja 1, neni 4 paragrafi 1, 4 dhe 5, neni 5 neni 10 dhe neni 11 paragrafi 5 të Rregullores për mënyrën, veprimin dhe kriteret e zgjedhjes së bashkëpunëtorëve të jashtëm dhe përcaktimi i shumës së kompensimeve autoriale dhe kompensimet e shërbimeve tjera të Byrosë së zhvillimit të arsimit nr. 01-2840/1 prej 16.04.2009, nr. 01-10943/1 prej 09.10.2009, nr. 01-12210/1 prej 18.11.2009, nr. 01-1207/2 prej 08.11.2013, nr. 01-534/1 prej 04.06.2014 nr. 01-534/2 prej 13.10.2014 dhe nr. 01-534/3 prej 31.10.2015, Byroja e zhvillimit të arsimit publikon

KONKURS

për zgjedhjen e bashkëpunëtorëve të jashtëm për punën profesionale të Byrosë së zhvillimit të arsimit

1. Për përpilimin e programeve mësimore për nxënësit në arsimin fillor dhe të mesëm edhe atë:

- 1.1. Programe të adaptuara/ reviduara në gjuhën angleze për klasën e I, II dhe IV në arsimin e mesëm profesional për nxënësit me pengesa në dëgjim, për profilin arsimor konfeksionist (drejtimi i tekstilit); *përpunues i metaleve dhe mekanik i përgjithshëm* – saldues (drejtimi makinerik).
- 1.2. Programe të adaptuara/reviduara në gjuhën angleze për klasën e I, II, III, IV dhe V në arsimin e mesëm profesional për nxënësit me pengesa me dëgjim, për profilin arsimor konfeksionist (drejtimi i tekstilit); *përpunues i metaleve dhe teknik mekanik (drejtimi makinerik)*.
- 1.3. Programi mësimor në bazat e baletit për klasën e III, në shkollën fillore për muzikë dhe balet.
- 1.4. Programe mësimore në gjuhën italiane (gjuha e dytë e huaj) për klasën e I, II, III dhe IV në arsimin fillor.
- 1.5. Programe mësimore në gjuhën italiane (gjuhë e huaj e dytë) për klasën e I, II, III dhe IV në arsimin fillor.
- 1.6. Programet mësimore në informatikë për klasën e VI dhe VII në arsimin fillor.
- 1.7. Programi mësimor në gjeografi për klasën e VII, VIII dhe IX në arsimin fillor.

2. Bashkëpunëtorët e jashtëm rangohen dhe përzgjedhjen sipas kriterëve vijues:

a) Bashkëpunëtorët e shkollave:

- arsimin sipëror për lëmin adekuate;
- minimum tre vjet përvojë në punën edukative – arsimore;
- punime të publikuara profesionale që janë me rëndësi për avancimin e arsimit dhe edukimit, në mënyrë të pavarur apo si pjesë e ekipit;
- pjesëmarrje me punimet e tyre në tubimet profesionale nga lëmi i arsimit;
- pjesëmarrje në projektet hulumtuese – zhvillimore nga lëmi i arsimit;

b) Bashkëpunëtorët e fakulteteve dhe institucioneve:

- së paku studime të magjistraturës;
- përvojë pune në veprimtarinë edukative – arsimore apo shkencore;

- punime të publikuara profesionale apo shkencore që janë me rëndësi për avancimin e edukimit dhe arsimit;
- pjesëmarrje me punimet e veta shkencore dhe profesionale për arsim;
- pjesëmarrje në projektet hulumtuese – zhvillimore në arsim.

c) Kriteret plotësuese për zgjedhjen e bashkëpunëtorëve të jashtëm

- njohja e njohurive kompjuterike
- aftësitë dhe shkathtësitë tjera për kryerjen e punëve.

Për përpilimin e secilit program mësimor do të zgjedhen më së shumti 2 (dy) bashkëpunëtor të jashtëm të cilët i plotësojnë kriteret e pikës 2 (a) dhe deri 2 (dy) bashkëpunëtor të jashtëm të cilët i plotësojnë kriteret e pikës 2 (b).

Mënyra e aplikimit dhe përzgjedhjen e bashkëpunëtorëve

Kandidatët duhet të dërgojnë fletëparaqitje në të cilën do të aplikohet pika nga konkursi për të cilin paraqiten dhe dokumentacioni vijues: biografia, vërtetimi për përvojën e punës, certifikatë dhe ngjashëm punime profesionale për plotësimin e kushteve me konkursin e publikuar.

Konkursi zgjat 7 (shtatë) ditë nga dita e publikimit në mjetet e informimit për informimin publik, duke mos konsideruar ditën e publikimit personalisht.

Bashkëpunëtorët e jashtëm të përzgjedhur të cilët do të jenë të inkuadruar në ekipin profesional e dërgojnë programin mësimor në Byronë që ka të drejtë të bëjë ndryshime profesionale dhe plotësime për shkak të përmirësimit të cilësisë.

Fletëparaqitjet me dokumentacion e pakompletuar (biografia, vërtetimi për përvojën e punës, certifikatë etj, punimet profesionale përkatësisht shkencore për plotësimin e kushteve të caktuara me konkursin publik) dhe që nuk dërgohen në kohë nuk do të jenë lëndë shqyrtimi.

Aplikimet me dokumentacionin e nevojshëm dorëzohen në arkivin e Byrosë së zhvillimit të arsimit – Shkup apo me postë me fletëdërgesën e rekomanduar në adresën e mëposhtme: Byroja e Zhvillimit të Arsimit, rr. „Rugjer Boshkoviç“ nr. 20, Karposh II, faksi postal, 1000 Shkup ose në adresën elektronike: irenaborisovska@bro.gov.mk, tel. 3089031)

Byroja e Zhvillimit të Arsimit



НАРОДНА БАНКА НА РЕПУБЛИКА МАКЕДОНИЈА

Në bazë të nenit 59 të Ligjit për Bankën popullore të Republikës së Maqedonisë, ndërsa në pajtim me nenet 14 paragrafi 1, 22 paragrafi 1 pika 1, 23 paragrafi 1 dhe 60 të Ligjit për marrëdhënie pune dhe neneve 6, 7, 23 paragrafi 1 dhe 30 të Marrëveshjes kolektive në nivel të Bankës popullore të Republikës së Maqedonisë, Banka popullore e Republikës së Maqedonisë publikon

SHPALLJE

Për punësimin të 3 realizuesve në Bankën popullore të Republikës së Maqedonisë, për kohë të pacaktuar

1. Një realizues në vendin e punës “përpilues i statistikave” në Referatin për punë kreditore dhe qarkullim pagesor me jorezidentë në Seksionin për grumbullim të të dhënave për statistika eksterne, një realizues në vendin e punës “përpilues i statistikave shkalla e II” në Referatin për portfolio, investime të drejtpërdrejta dhe kredi tregtare në Seksionin për grumbullimin e të dhënave për statistika eksterne dhe një realizues në vendin e punës “këshilltar i pavarur analist” në Seksionin për përpilim dhe publikim të të dhënave për statistika eksterne në Drejtorinë për statistikë.

2. Kandidatët të cilët do të lidhin marrëdhënie pune në vendet e punës nga pika 1, krahas kushteve të përgjithshme me ligj për lidhje të marrëdhënies së punës duhet të përmbushin edhe kushtet e posaçme në vijim:

-Për vendet e punës “përpilues i statistikave” në Referatin për punë kreditore dhe qarkullim pagesor me jorezidentë dhe “përpilues i statistikave shkalla e II” në Referatin për portfolio, investime të drejtpërdrejta dhe kredi tregtare në Seksionin për grumbullimin e të dhënave për statistika eksterne në Drejtorinë për statistikë të ketë: fakultet të mbaruar nga sfera e shkencave ekonomike së paku 180 kredi SETK (VIB), së paku 2 vjet stazh pune të arritur pas përfundimit të arsimit sipëror, njohje të gjuhës angleze, njohje të punës me kompjuter dhe njohje nga sfera e punës së Bankës popullore.

- Për vendin e punës “këshilltar i pavarur analist” në Seksionin për përpilim dhe publikim të të dhënave për statistika eksterne në Drejtorinë për statistikë të ketë: fakultet të mbaruar nga sfera e shkencave ekonomike së paku 240 kredi SETK (VIA), së paku 4 vjet stazh pune të arritur pas përfundimit të arsimit sipëror, njohje të gjuhës angleze, punës me kompjuter dhe njohje nga sfera e punës së Bankës popullore.

3. Kandidatët nga pika 1 duhet të paraqesin: fletëparaqitje, biografi të shkurtë, diplomë ose certifikatë për arsim sipëror nga sfera e shkencave ekonomike, dëshmi për njohje të gjuhës angleze, dëshmi për njohje të punës me kompjuter dhe dëshmi për stazh të punës nga Fondi për sigurim pensional dhe invalidor të Republikës së Maqedonisë.

4. Orari i punës në javën e punës, fillon mes orës 8.00 dhe 9.00, ndërsa përfundon mes orës 16.00 dhe 17.00.

5. Me kandidatin me të cilin do të lidhin marrëdhënie pune për vendet e punës nga pika 1, ndërsa kanë stazh të punës do të lidhet marrëveshje për punësimin për kohë të pacaktuar, duke kryer punë testuese në kohëzgjatje prej 1 muaj.

Shuma e pagesës themelore (neto) e punëtorit për vendin e punës “përpilues i statistikave” në Referatin për punë kreditore dhe qarkullim pagesor me jorezidentë në Seksionin për grumbullimin e të dhënave për statistika eksterne do të jetë 21.479,00 denarë.

Shuma e pagesës themelore (neto) e punëtorit për vendin e punës “përpilues i statistikave shkalla e II” në Referatin për portfolio, investime të drejtpërdrejta dhe kredi tregtare në Seksionin për grumbullimin e të dhënave për statistika eksterne do të jetë 22.926,00 denarë.

Shuma e pagesës themelore (neto) e punëtorit për vendin e “këshilltar i pavarur analist” në Seksionin për grumbullim përpilim dhe publikim të të dhënave për statistika eksterne do të jetë 26.367,00 denarë.

6. Afati për dorëzimin e dokumenteve është 5 ditë pune, duke llogaritur nga dita e ardhshme e ditës së publikimit të shpalljes.

7. Zgjedhja e punëtorit i cili do të lidhë marrëdhënie pune në Bankën popullore do të realizohet në afat prej 45 ditëve nga dita e kalimit të afatit për paraqitje.

8. Dokumentacioni i dorëzuar pas afatit dhe i pakompletuar nuk do të merret parasysh.

9. Fletëparaqitja është e publikuar në internet faqen e Bankës popullore të Maqedonisë.

Fletëparaqitjet së bashku me dokumentacionin e nevojshëm të dorëzohet në Arkivin e Bankës popullore të Republikës së Maqedonisë, bul. “Kuzman Josifovski Pitu” nr. 1 – Shkup.

Banka popullore e Republikës së Maqedonisë

Në bazë të pikës I të Programit për trajnim dhe provim të drejtorëve të shkollave fillore dhe të mesme (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 219/15), në lidhje me nenin 6 të Ligjit për trajnim dhe provim për drejtor të shkollës fillore, shkollës së mesme, konviktit të studentëve dhe universitetit të hapur qytetar për mësim të përgjithshëm (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 10/15, 145/15, 192/15 dhe 30/16), Qendra shtetërore për provime publikon:

KONKURS

për zgjedhje të trajnuesve

Qendra shtetërore për provim shpall Konkurs për zgjedhje të bashkëpunëtorëve të jashtëm – trajnues të cilët duhet të realizojnë Programin për trajnim dhe provim të drejtorëve të shollave fillore dhe të mesme, edhe atë nga një trajnues në gjuhën maqedonase për:

- Moduli nr. 1 – Aplikimi i teknologjisë informatike-kompjuterike gjatë menaxhimit në arsim;
- Moduli nr. 2 – Teoria e organizimit;
- Moduli nr. 3 – Njerëzit në organizatë;
- Moduli nr. 4 – Drejtori si udhëheqës pedagogjik;
- Moduli nr. 5 – Financat;
- Moduli nr. 6 – Ligjvënja.

Kualifikimet e nevojshme:

Kandidatët për trajnues për modulet prej 1 deri në 6 nga Programi për trajnim dhe provim të drejtorëve të shollave fillore dhe të mesme, duhet të paraqesin dëshmi se përmbushin kushtet e përgjithshme në vijim:

- Të kenë së paku arsim sipëror të mbaruar – nivelin VII A të kornizës nacionale të kualifikimit;
- Të kenë së paku 5 vjet përvojë pune në veprimtari edukative-arsimore dhe shkencore dhe
- Përvojë si trajnues nga sfera e përmbajtjes së modulit për të cilin konkurron.

Si dhe kushtet e posaçme në vijim:

- Të kenë të mbaruar së paku studime akademike të ciklit të dytë nga sfera përkatëse;
- Të kenë të publikuar punime profesionale, gjegjësisht shkencore që janë në funksion të nevojës aktuale;
- Të marrin pjesë me punimet e tyre në tubimet shkencore dhe profesionale.

Gjithashtu duhet të paraqesin edhe Plan për realizim të përmbajtjeve të modulit për të cilin konkurrojnë, i cili duhet të përmbajë tërësi, përmbajtje, kohëzgjatje, metodologji dhe resurse të nevojshme për secilën temë veç e veç.

Kandidatët duhet të kenë përvojë në përpilimin e pyetjeve të provimit dhe aftësi të zhvilluara komunikimi.

Kandidati në fletëparaqitje me të cilin paraqitet për trajnues, duhet të theksojë se si trajnues i cilit modul paraqitet. Së bashku me fletëparaqitjen kandidatët paraqesin edhe dokumentacionin e tërësishëm për përmbushje të kushteve të konkursit të publikuar dhe biografi të shkurtë.

Fletëparaqitjet me dokumentacion të pakompletuar dhe jovalide, si dhe fletëparaqitjet të cilat do të arrijnë pas afatit të përcaktuar në këtë konkurs, nuk do të merren parasysh gjatë shqyrtimit.

Qendra shtetërore për provime do të bëjë përzgjedhjen sipas kriterëve të lartpërmendura, ndërsa kandidatët të cilët do të futen në rrethin e dytë do të intervistohen, pas çka do të vijojë zgjedhja përfundimtare.

Kandidatët të cilët do të zgjidhen si trajnues do të angazhohen për periudhën prej dy viteve.

Kandidatët e interesuar mund të paraqesin dokumentet e nevojshme në afat prej 7 ditëve të punës, duke konsideruar nga dita e publikimit të konkursit në mjetet e informimit publik.

Fletëparaqitja së bashku me dokumentacionin paraqetohet në lokalet e Qendrës shtetërore për provime, në rr. “Vasil Gjorgov” pn, Shkup.

Informacione shtesë mund të merren në numrat e telefonit 02/3 228-866 dhe 075/300-606 në periudhën prej ora 10 deri në ora 12 dhe prej ora 13 deri në ora 15, çdo ditë pune.

Koha, e enjte 7 dhjetor, 2017

JASIR ASANI FLET PËR PËRSHTYPJET E TIJ TE PARTIZANI

JAM DUKE E KAPUR FORMËN QË MË DUHET TË ARRIJ

“Që kur erdha në fillim te Partizani e dija se më pret një punë e madhe në skuadër. Të gjithë lojtarët më kanë mbështetur dhe me kalimin e ditëve jam duke e kapur formën që më duhet të arrij”, shprehet Asani

Shkup, 6 dhjetor - Me rikthimin e Sulejman Starovës në krye të Partizanit nga Tirana, është rikthyer edhe qetësia, falë rezultateve pozitive. Derisa, një nga lojtarët, të cilët po luan titullar me “Bobin” është edhe futbollisti shkupjan Jasir Asani, i ardhur merkaton e verës. Ai për mediat nga Shqipëria ku ka folur për shumë gjëra, por fillimisht ka folur për pershtypjet e tij pas pak muajsh me Partizanin. “Që kur erdha në fillim te Parti-

zani e dija se më pret një punë e madhe në skuadër. Të gjithë lojtarët më kanë mbështetur dhe me kalimin e ditëve jam duke e kapur formën që më duhet të arrij”, u shpreh Asani, i cili tregon edhe pritshmëritë e tij me skuadrën nga Tirana. “Unë kam miqësi me Ylber Ramadanin dhe Bujamin Shabanin, ish-lojtarë të Partizanit. Ata më kanë folur shumë për këtë skuadër dhe dëshira ime ishte të luaj dhe të kontribuoj për Partizanin. Jemi në një situatë jo të mirë në renditje, pasi Partizani duhet të jetë në vendin e parë, por besoj se të gjithë lojtarët e dinë që duhet të japim maksimumin. Është ende faza e dytë për t’u luajtur. Është shumë shpejt për të thënë që kampionati ka mbaruar për ne, pasi jemi duke u ringjallur dhe

fitoret po vijnë. Besoj se mund ta arrijmë vendin e parë, pasi për ne nuk ka mbaruar kampionati dhe të gjitha ndeshjet janë finale. Të dielën luajmë ndaj Teutës dhe do të japim të gjithë maksimumin”, shtoi më tej ish-futbollisti i Vardarit, Shkupit dhe Pobedës. Në fund ai pranon se është i kënaqur me pozicionin ku luan, derisa flet edhe për performimin e paralajmëruar Lukas. “Po, ndihem shumë mirë dhe jam i kënaqur.

Gjithmonë kam luajtur në atë pozicion dhe mund të kthehem atje ku duam. Sa i përket brazilianit Lukas, kam luajtur kundër tij, e njoh dhe është superlojtar. Besoj se do të na bëjë punë. Por, tani për tani duhet të mendojmë për ndeshjet e radhës”, përfundoi Jasir Asani.

Partizani pas Abdurahimit

Duket se tregu maqedonas është kthyer në të preferuarin e Partizanit, që ka hequr dorë përfundimisht nga tregu italian, pas dështimit në merkaton e verës. Ditët e fundit “Sport Ekspres” mësoi se Partizani ka arritur marrëveshjen me sulmuesin e Pelisterit, brazilianin Lukas, i cili praktikisht është i kuq dhe pritet vetëm marrëveshja mes klubeve, për transferim që në janar me ndonjë pagesë nga Partizani, apo falas në fund të sezonit. Ndërkaq, “supersport.al” raporton se të kuqtë kanë hedhur sytë edhe nga sulmuesi i Shkëndijës së Tetovës, Besart Abdurrahimi, i cili si duket nuk bën pjesë në planet e trajnerit Qatip Osmani duke marrë parasysh se nuk përfshihet si lojtar titullar. Bëhet fjalë për një sulmues 27-vjeçar me CV shumë të pasur, sepse ka luajtur për shumë vite te NK Zagrebi për shumë vite, deri më 2013. I lindur në Kroaci, por me pasaportë kroate, duke luajtur edhe për kombëtaren, Abdurrahimi ka luajtur edhe te Hapoeli i Tel Avivit, te Lokereni në Belgjikë, Astana në Kazakistan dhe Çerezko Osaka në Japoni. Nëse Partizani i jep garanci se do të luajë rregullisht, Abdurrahimi do t’i kërkojë Shkëndijës ta lërë të lirë dhe zor se klubi tetovar do të refuzojë.



Kur erdha, ditët e para, nuk isha në formën time më të mirë dhe mu desh pak kohë që të arrija kondicionin e duhur, por tani forma do të vijë duke u rritur.

Mediat i dalin në mbrojtje Berishës



Një gabim në ndeshjen e fundit ndaj Torinos bëri që portieri shqiptar të përfshihej në një sërë kritikash nga media të ndryshme në Itali. Mirëpo, portali më i madh informativ në qytetin e Bergamos i ka dalë në mbrojtje Etrit Berishës me një shkrim kushtuar paraqitjeve të tij dhe nevojave që ka Atalanta për vlerat që ai tregon në fushë. “Në një kampionat nevojitet një sulmues që të shënojë 20 gola dhe një portier që të ofrojë siguri. Gaspe-

rini nuk e ka një të tillë bomber, por në portë ka një portier të gjatë 194 centimetra. Berisha ofron siguri në kuartat, pavarësisht se ndaj Torinos duhet të kishte bërë më mirë në atë dalje. Nuk duhet harruar as ajo që bëri në pjesën e parë kundër Obit dhe Ljajiç. Gjithashtu, ndaj Belotit në të dytën ruajti rezultat. Në të mirë dhe të keqe, Berisha është siguri dhe i nevojshëm për Atalantën”, shkruhej për shqiptarin.

Rruga e mundimshme e Romelës deri te medalja

Romela Begaj arriti të shkruajë një faqe të re të historisë së peshëngritjes shqiptare me medaljen e marrë në Botërorin e Amerikës. Pas një periudhe të gjatë dëmtimesh dhe mungese në rezultatet e larta, Romela ishte e vetmja që mbajti lart flamurin shqiptar në këtë kampionat. Për “Top Channel”, ajo tregon emocionet e garës. “Kam pasur vështirësi të mëdha dhe ia arrita. Gara për mua ishte shumë e kënaqshme. Gara gjithmonë ka të papritura, por unë në fund ia dola. Unë u ktheva aty ku kam qenë, por maksimumi im nuk ishte aq”, tha Begaj në një intervistë te-

lefonike nga Athina. Në tentativën e fundit, peshëngritësja shqiptare Begaj jo vetëm që nuk mundi të ngrejë shtangën, por edhe u dëmtua. “Kam bërë një skaner dhe kam një dëmtim në shpatull. Dëmtimi nuk është i lehtë, por shpresoj që të rikthehem këtu për një kurim më të specializuar”, deklaroi Begaj. Një arritje kaq të madhe Romela Begaj, përveç vendit të saj dhe familjes, ka dhe një person të veçantë që ia dedikon: bashkëshorti dhe trajneri i saj Gazmend Akcani: “Dedikim special për trajnerin tim Gazmend Akcani dhe familjen time”.



LIGA E KAMPIONEVE

“Ndeshja ndaj Karabagut ku qëlluar portën 10 herë pa shënuar, është vështirë për t'u sqaruar. Fundi i një epoke? Jo, është e kundërta, kjo ka hapur një sfidë të re për entuziazmin tonë që të vazhdojmë luftën. Gjithçka e keqe është e mirë për ne”, thotë Simeone

Trajneri i Atletico Madridit, Diego Simeone, ka këmbëngulur se eliminimi nga Liga e Kampionëve nuk është fundi i epokës, por një fillim i ri. Kujtojmë, Atletico u eliminua nga faza e grupeve për herë të parë nën drejtimin e Simeones kur të martën barazoi me Çellsin në “Stamford Bridge” dhe Roma mposhti Karabagun në shtëpi. “Dhemb pa dyshim sepse futbolli di të jetë i mrekullueshëm. Ne jemi eliminuar pasi morëm më shumë pikë ndaj top ekipit se sa ndaj ekipit të fundit në tabelë. Nuk

do të kërkojmë arsye, por do të marrim përgjegjësi. Ndeshja ndaj Karabagut ku qëlluar portën 10 herë pa shënuar, është vështirë për t'u sqaruar. Fundi i një epoke? Jo, është e kundërta, kjo ka hapur një sfidë të re për entuziazmin tonë që të vazhdojmë luftën. Gjithçka e keqe është e mirë për ne”, deklaroi Simeone.

Ndryshe, trajneri i Romës Eusebio Di Françesko është shprehur i kënaqur me kualifikimin e Romës nga pozita e parë në Grupin C që është konsideruar si “grupi i vdekjes”. “Giallorossët” arritën të tregoheshin më të fortë se skuadrat, si Çellsin e Atletico Madridi, për të vazhduar tutje si lider. Trajneri i skuadrës italiane thotë se kur ishte ndarë shorti, shumëkush kishte parashikuar se ekipi i tij do të elimi-

nohej në fazën grupore. “Ishte një fitore e shkëlqyer, e vështirë, sidomos për faktin se unë nuk kam përvojë në Ligën e Kampionëve. Por, është e kënaqshme, sepse askush nuk ka besuar se ne do të kualifikoheshim, të gjithë parashikonin se ne do të eliminohehim, por ne

punuam shumë, e treguam vetën dhe fituam si grup. E gjitha filloi me barazimin 0-0 ndaj Atletico Madridit, kur ne sapo kishim filluar dhe po e gjenim veten, por vuajtëm dhe u mbajtëm, për atë që u tregua si pikë vendimtare”, ka thënë Di Françesko.

MBAPPE VENDOS REKORDIN E RI TË LK

Kylian Mbappe shënoi kundër Bajernit golin e tij të 10-të në Ligën e Kampionëve. Në moshën 18-vjeç e 11 muaj, ai është bërë lojtari më i ri që arrin ndonjëherë këtë shenjë. Dhe ai e bëri këtë me një diferencë të caktuar! Mbappe është pothuajse dy vjet më i ri se Karim Benzema, mbajtësi i mëparshëm i rekordit, me pothuajse 20 vjeç e dhjetë muaj. Kjo arritje nuk është e vetmja shifër mbresëlënëse për yllin e PSG-së, gjë që e bëri atë të vetmin adoleshent në Ligën e Kampionëve të sotme për të arritur “shenjën”. Ndërkohë, numri 6-të në listën e të gjitha kohërave, Uejn Runi, e arriti këtë “stacion” dy javë pas ditëlindjes së tij të 22-të, duke luajtur për Junajtedin. Mbappe shënoi gjashtë herë sezonin e kaluar, duke luajtur në “Champions” deri në gjysmëfinale me Monakon. Ai ka vazhduar të shtojë katër gola në totalin e tij këtë sezon, pas lëvizjes te PSZH-ja.

DËMTOHET LOJTARI I SANDERLENDIT

Drejtuesit e Realit i shkruajnë letër

Është vetëm 23 vjeç, por futbolisti i Sanderlendit, Dankan Uatmore, ka lënduar ligamentet për herë e dytë brenda një kohe të shkurtër. Pasi kanë dëgjuar për këtë klubin e Real Madridit i ka dërguar letër lojtarit për t'i dhënë zemër që të kthehet sa më shpejtë. Lojtari ka marr shumë mesazhe mbështetëse, por asnjë nuk e ka prekur më shumë se ai i dërguar nga “Los Blancos”. Uatmore sa ishte kthyer në fushë me “Macet e Zeza” dhe babai i lojtarit ishte ai që e ka publikuar letrën e dërguar nga “mbretërit”. Letra është dërguar në emrin e Florentino Perez dhe është nënshkruar nga legjenda e klubit Emilio Butragueno. “Në emër të presidentit tonë Florentino Perez dhe të gjithë atyre që punojnë në



klubin e Real Madridit, ju dëshirojmë rikthim të lehtë dhe të shpejtë nga lëndimi në gju”, shkruhet në letër. Kjo i ka bërë përshtypje babil të lojtarit, Ian Uatmore, i cili ka shkruar se Reali është klub me klas. “Çfarë klasi ka Real Madridi! Tani unë shpresoj që ata ta fitojnë Ligën e Kampionëve”, ka shkruar Ian Uatmore në “Twitter”. Dankan Uatmore luan si anësor për klubin e njohur anglez që tani bën pjesë në Çampionship.

BUFON NDEROHET NË GREQI

Gianluigi Buffon nuk ishte në fushë kundër Olimpiakosit, në kualifikimin e Juventusit në fazën e 16-të më të mirave në Evropë. Klubi grek e ka nderuar legjendën e futbollit italian Buffon për të arriturat në karrierë. Olimpiakosi kishte vendosur pasi ishte ndeshja e fundit në grupe për ta por edhe për Buffonin në karrierën e tij.




Braktisa gjykimin në Angli prej Murinjjos



Në fillim të këtij viti gjyqtari i njohur anglez, Mark Klattenburg, deklaroi se do të hiqte dorë nga arbitrimi në Premier Ligë për t'u zhvendosur në Arabinë Saudite pas ofertës së federatës aziatike për të marrë drejtimin e departamentit të gjykimin në këtë institucion. 42-vjeçari, në prononcim të fundit ka zbuluar se këtë vendim e kishte marrë menjëherë pas kritikave të Murinjjos në përfundim të ndeshjes mes Mançester

Junajtedit dhe Stok Sinit, që u mbyll në barazim 1-1 (Uejn Runi theu rekordin e Sër Bobi Çarlton si golashënuesi më i mirë i të gjitha kohërave për “Dajtë e Kuq”). “Murinjo erdhi në dhomat e zhveshjes së arbitrave, pasi ishte i mërzitur që nuk i kisha akorduar një 11-metërsh për prekje me dorë të topit në zonë. E ndjeja që performanca ime ishte e mirë në një stadium të “nxehtë”. Të gjykohe Mançesterin nuk është asnjëherë e lehtë. Mirëpo Murinjo më futi në mendime. Isha i bindur se kisha vepruar drejt. Pastaj i bëra pyetje vetes: a duhet të jem akoma pjesë e kësaj? E kuptova që kjo punë nuk po më jepte më kënaqësi, ndaj vendosa të largohesha”, deklaroi Klattenburg. 42-vjeçari ka gjykuar për herë të parë në Premier Ligë në vitin 2004, ndërsa konsiderohej një nga gjyqtarët më të mirë të FIFA-s, të cilit i janë besuar ndeshje shumë të rëndësishme ndërkombëtare.

Duncan went to rehab today to find this letter waiting for him. How classy is that from @realmadrid? I now hope they win the Champions League again!



Jetoje jetën siç dëshiron vetë!

Vetëm kur jeni pa brenga mund t'i shkruani faqet më të bukura të jetës. Siguria është ajo që ju jep elan për t'i pranuar sfidat, të shijoni mundësitë. E dini se vendimi për një të nesërme më të mirë është tani, prandaj investoni në një të ardhme të sigurt për ju dhe për familjen tuaj.



Triglav
sigurimi
i jetës me
kursim.



Triglav Sigurimi | Jetës

triglav

www.triglavzivot.mk

Lansohet telefoni i palosshëm më i fuqishëm në botë

Samsung dhe China Telecom kanë lansuar telefonin e quajtur W2018, një telefon i palosshëm i avancuar Android, me dy ekrane të ndjeshëm në prekje dhe lentet e kamerës më të shkëlqyeshme se çdo smartfon tjetër. Ngjarja është mbajtur në Xiamen, Kinë dhe është festuar 10 vjetori i serisë W dhe 25 vjetori i Samsungut në tregun kinëz. Samsung W2018 ka dy ekrane 4.2-inç AMOLED me rezolucion Full HD, procesor Snapdragon 835, 6 GB RAM memorie dhe 64 ose 256 GB memorie të brendshme, transmeton Koha.net. W2018 është telefoni i parë i palosshëm me Bixby dhe Samsung me krenari njofton se asistenti AI tani ofron mbështetje edhe për gjuhën kinëze. Në pjesën e pasme të këtij telefoni është vetëm një kamerë prej 12 megapikselë me lente më të shkëlqyesh-



me se çdo smartfon tjetër. Po ashtu, në dispozicion është edhe OIS. Në pjesën e përparme gjendet kamera prej 5 megapikselë. W2018 me kamerën kryesore mund të incizojë videot me rezolucion prej 4K.

Gjithashtu, Samsung W2018 vjen me baterinë prej 2,300 mAh, portin USB-C dhe me porte hibride për SIM kartela (ose për kartela të memories). I mungojnë shërbimet e Google sikur shumicës së pajisjeve vetëm për Kinë si dhe punon me sistemin operativ Android Nougat 7.1.1. Samsung W2018 ofrohet me ngjyrë të zezë, por gjithashtu në dispozicion janë edhe njësit e limituara me ngjyrë ari dhe argjendi. Versioni bazik kushton më shumë se 2,000 euro në JD dhe TMall.



Martohuni, psikologët thonë që është "ilaç"

Duket se martesë ndikon në më shumë gjëra, se sa thjesht lumturi. Një studim i publikuar në Journal of Neurology, Neurosurgery & Psychiatry ka zbuluar se të qenit i vetëm për pjesën tjetër të jetës mund të rrisë rrezikun e zhvillimit të problemeve mendore me 42 për qind në krahasim me çiftet e martuara. Njerëzit që janë të ve, gjithashtu janë në një rrezik të madh, me një shans prej 20 për qind. Studiuesit nga University College London shqyrtuan 15 studime të veçanta, ku analizuan lidhjen mes rrezikut të çmendurisë dhe statusit martesor. Duke kombinuar rezultatet nga 15

studimet, studiuesit ishin në gjendje të analizonin të dhënat në mbi 800.000 njerëz në mbarë botën. Sipas Dr Laura Phipps nga Research UK për Alzheimer, ka shumë arsye pse martesë mund të çojë në një numër përfitimesh shëndetësore. "Njerëzit që janë të martuar prirën të jenë më mirë financiarisht, një faktor që është i ndërthurur me shumë aspekte të shëndetit tonë. "Bashkëshortët mund të ndihmojnë në nxitjen e zakoneve të shëndetshme, të kujdeset për shëndetin e partnerit të tyre dhe të ofrojnë mbështetje të rëndësishme sociale". Dr. Andrew Sommerlad, një psikiatër në UCL dhe një nga studiuesit e studimit, shpj-

goi se si një jetesë të shëndetshme mund të ketë një ndikim të drejtpërdrejtë në shëndetin tuaj mendor. "Një gjë që ndodh kur dikush po bënë një çmenduri është akumulimi i dëmeve brenda trurit", tha Dr. Sommerlad për The Independent. Shoqërimi i martesës dhe kujdesi që partnerët sigurojnë për njëri-tjetrin mund të jenë faktorë që kontribuojnë në uljen e rrezikut të sëmundjes mendore. Publikimi i studimit përkon me nisjen e fushatës së Alzheimer's Research UK Christmas, fushatës së Santa Forgot. Fushata, e cila mbështetet nga Stephen Fry, po përpiqet të mbledhë fonde dhe ndërgjegjësim e personave.



KALENDARI HISTORIK 7 DHJETOR

43 BC - Vritet Markus Tullius Cicero.
1732 - Hapet Shtëpia Mbretërore e Operës në Covent Garden, Londër.
1741 - Elizabeta Petrovna shpallet carinë e Rusisë.
1895 - Beteja e Amba Alagi: Abisinët mundin armatat italiane.
1912 - Busti i Mbretëreshës Nefertete gjendet në El-Amarna, Egjipt.
1941 - Japonëzët sulmojnë Pearl Harbor.
1944 - Gjenerali Radesku formon qeverinë rumune.
1953 - Pensionohet Kryeministri izraelit Ben-Gurion.
1960 - Bregu i Fildishtë shpall pavarësinë nga Franca.
1966 - Kaplohet zjarr në barakat ushtarake në Erzurum, Turqi, ku vdesin 68 persona.
1970 - Gjermania Perëndimore dhe Polonia normalizojnë marrëdhëniet.
1975 - Ushtria e Indonezisë okupojnë Timorin Lindor.
1981 - Spanja bëhet anëtare e NATO-s.



A E DINI SE...

Më 3 dhjetor 1992 u dërgua SMS e parë. Më pas mesazhet që dërgoeshin me celularë u sollën kompanive të telefonisë të ardhura milionëshe. Dhe edhe sot megjithë konkurrencën e shërbimeve të tjera, dërgimi i mesazheve nuk ka marrë fund. Konceptin e sms-ve e ideuan gjermani Friedhelm Hillebrand dhe francezi Bernhard Gillebaert. Pra sms-të janë një shpikje gjermano-franceze. Në mes të viteve 1990 kur telefonia mobile dhe celularët shënuan një bum ofruesit e shërbimit sms nxorën fitime të mëdha. Në vitin 1996 p.sh. në Gjermani u dërguan 100 milionë sms, kurse në vitin 2012 rreth 50 miliardë. Një sms kushtonte 39 cent dhe fitimet ishin tepër të mëdha.



BARSOLETA

PUNA ME KAFSHË

Një turist kishte shkuar në lartësitë e maleve dhe pranë një stani takon një bari.
- Me çfarë merreni këtu gjatë gjithë vitit?
- Duhet të dish se kur merresh me kafshët ke gjithnjë punë. Në vjeshtë janë delet, gjatë dimrit dhitë, në pranverë lopët, kurse në verë vini ju turistët.



THËNIA E DITËS



T'i kërkosh pushtetin që të reformojë pushtetin...
çfarë naiviteti!
(Xhordano Bruno)